


Mimoza Gjokutaj Anila Mullahi Tereza Babasuli



BOTIME

pegi

Fletore pune Gjuhë shqipe

8

Prof. dr. Mimoza Gjokutaj Prof. as. dr. Anila Mullahi Msc. Tereza Basho Babasuli

FLETORE PUNE GJUHË SHQIPE 8

Për klasën e 8-të të arsimit 9-vjeçar

BOTIME



Prishtinë, 2024



BOTIME



Drejtoi botimin: Arlinda RRUSHI

Recensentë të MASHTI-t:

?????????????

Redaktore letrare: Aida BARO

Korrektore letrare: Oriada DAJKO

Paraqitja grafike dhe kopertina: Elvis BEJTJA

Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

ISBN: 978-9951-843-21-8

© Botime Pegi sh.p.k., dega në Kosovë, maj 2024

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Të gjitha tekstet letrare dhe joletrare të këtij libri janë përshtatur dhe redaktuar për qëllime didaktike.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;

e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al

Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;

e-mail: marketing@botimepegi.al

Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;

e-mail: shtypshkronjaapegi@yahoo.com

Hyrje

Fletorja e punës i shërben kontrollit të arritjeve të nxënësve në fushat përkatëse të programit të *Gjuhës shqipe 8*. Kjo fletore vjen si një zhvillim brenda paketës së re kurrikulare të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë. Ajo mbështet këtë program për njohjen dhe arritjen e kompetencave kyçë dhe atyre të fushës.

Çdo fletë pune e kësaj fletoreje lidhet me arritjet e nxënësve për konceptet: teksti letrar; teksti joletrar; gjuha figurative dhe jofigurative; kultura, kritika e historia; sistemi gjuhësor, të cilat realizohen nëpërmjet shkathtësive të komunikimit: të dëgjuarit e të folurit, të lexuarit, të shkruarit.

Secila prej fletëve të punës mban të njëtin titull që është zgjedhur për njësinë mësimore në librin e nxënësit, në mënyrë që përdorimi i fletores të jetë sa më i lehtë si nga nxënësit, ashtu edhe nga mësuesit.

Fletorja e punës mbështet librin në strukturën dhe përbajtjen e tij dhe është një dokument autentik që tregon përparimin e nxënësve, përmes të cilit ata vetëvlerësohen dhe vlerësohen, duke dëshmuar arritjet dhe progresin e tyre hap pas hapi.

Si pjesë e paketës kurrikulare, kjo fletore u vjen nxënësve e bashkëngjitur me tekstin mësimor dhe ka vlera njohëse, kërkimore dhe zbatuese.



Përbajtje

Teksti letrar

Kush e solli Doruntinën?	7
Ciklopi	8
Urtësia e popullit	9
Djaloshi i gurtë	10
Kujtimet	11
Një jetë e vështirë	12
Kthimi i Skënderbeut në Krujë	13
Komandanti i klasës	14
Një medalje për madhështinë	15
Bora e fëminisë	16
Purpuranti	17
Shuarja e humorit	18
Liliputët	19
Të rrethuar nga ujqit e kuq	20
Përleshja e kryetimit me kryepiratin	21
Nëndhesja	22
Një mik i paharruar	23
Borfor – provat e Askanos	24
Roboti që donte të flinte	25
Busulla e artë	26
Kur nëna ime...	27
Shpell'e Dragobisë	28
Vrull	29
Kosovës	30
Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes	31
Mëma	32
Shqiponja	33
Të dua baltë shqiptare	34
Leni lumejt...	35
Besëlidhja shqiptare	36
I sëmuri për mend	37
Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden	38
Prometeu i mbërthyer	39

Teksti joletrar

Nanë e dashtun!	40
Idriz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë	41
Erza, shqiptarja me famë botërore nga muzika drejt kinematografisë	43
Gjirokastra	44
Kulti i disa gjallesave të natyrës	45
Zogjtë	46
Gjashtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar	47
Përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit	48
A duhet të lejohen celularët në shkolla?	50
Vendi me më shumë libra sesa banorë	51

Njohuri për gjuhën

Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe	52
Përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjëzave, pikëpresjes dhe kllapave	53
Përdorimi i trepikëshit (...)	54
Fjalët me ngjyrim emocional	55
Kuپimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve	56
Gjuha standarde dhe dialektet	57
Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja	58
Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën	59
Përemri pronor	60
Përemri vvetvetor dhe përemri pyetës	61
Folja në mënyrat kushtore dhe habitore	62
Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore	64
Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore	65
Pasthirrma	69
Pjesëza	70
Ndërtimi i fjalisë dhe analiza gramatikore e saj	71
Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali	72
Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje	73
Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, llojet e tyre	76
Fjalitë e përbëra me nënrenditje ftilluese: kryefjalore, kundrinore	77
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: kohore, vendore	79
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: shkakore, qëllimore	80
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: mënyrore, rrjedhimore	82
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: kushtore, lejore	83
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: krahasore	84
Fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore	85
Përdorimi i presjes në fjali	87

Kush e solli Doruntinën?

- 1** Përmes shembujve, shtjelloni disa karakteristika të baladës.

	Përshkrimi i ngjarjes	Përshkrimi i ndjenjave	Detajet fantastike	Pika kulmore e ngjarjes
Shembull nga balada				
Shpjegimi				

- 2** Përgjigjuni me shkrim pyetjeve të mëposhtme.

Çfarë dinit më parë rreth kësaj balade?

Çfarë mësuat rreth saj?

Çfarë doni të mësoni më tej rreth kësaj balade?

- 3** Shkruani përshtypjet që ju la fundi i baladës.

Ciklopi

- 1** Duke u nisur nga historia e Odisësë me Ciklopin, reflektoni mbi raportin e forcës fizike me forcën mendore. Më mirë i fortë apo i zgjuar?

Urtësia e popullit

1 Proverbat e mëposhtme janë shkruar nga Naim Frashëri. Grupojini ato sipas tematikës.

Zemra që është e qëruar, kurdoherë është e gëzuar.
 Kush përpinqet e punon, gjithë punët i mbaron.
 Duaje atën' edhe mëmën, të jesh fatbardhë në jetë.
 Thuaj fjalën e mirë, e bëj punën e mbarë.
 Gënjeshtra kurrë mos thuaj, e gjë s'ka të ngjarë.

Duaj motrën e vëllanë, bëje zakon dashurinë, duaj atë që ke pranë, edhe gjithë njerëzinë.
 Përtorjësi ësht' i mjerë, punëtori e gjen ndërë.
 Mendo pa fol, mos thuaj ç'do.
 Trupi shëndoshet me të punuar, mendja ndritohet me të mësuar.

2 Lidh me vijë fjalët e urta që janë sinonimike me njëra-tjetrën, pra kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt.

Është më afër dera se qilar!
 Pula e botës të duket më e majme.
 Kroj i mirë njihet në kohë të thatë.
 Kush fle me qentë, ngrihet me pleshta.
 Kusia mbi prush, thëllëza në fushë.
 I zoti e di ku i pikon çatia.

Pula e fqinjtit (e tjetrit) të duket patë.
 Është më afër gusha se fusha.
 Peshku në det, tigani në zjarr.
 E di vetë gomari ku e vret samari.
 Më thuaj me kë rri, të të them se cili je.
 Miku i mirë njihet në ditë të vështirë.

3 Me cilin nga proverbat e mëposhtëm kuptojmë "kur s'ke mundësi tjetër, pranon diçka më të keqe nga ajo që dëshiron"?

- a) Kur s'ke pula, mos bëj "ish".
- b) Kur s'ke pula, pse hahesh me dhelprat?
- c) Kur s'ke pulën, ha edhe sorrën.
- ç) Më mirë një vezë sot, se një pulë mot.

4 Me cilin prej këtyre proverbave kuptojmë "mos u merr me punë që nuk të përkasin"?

- a) Mos i shiko gunën, por shikojti punën.
- b) Mos shtjer kripë në gjellën e botës.
- c) Hunda në lis, morri në kurriz.
- ç) Luga e madhe të shlyen gojnë.

5 Zbërtheni kuptimin e këtyre fjalëve të urta.

Bëja shokut atë që do për vete. _____
 Kush i hap gropën tjetrit, bie vetë brenda. _____
 E keqja është një kodër. Secili hipën mbi të vetën e flet për atë të tjerëve. _____
 E keqja vjen fluturim e ikën çalë-çalë. _____
 E keqja di ku fle e keqja. _____
 Fjala e burrit si pesha e gurit. _____

Djaloshi i gurtë

- ## 1 Çfarë simbolizojnë fjalët e mëposhtme?

libri

pushka

ibriku me ujë

- 2** Duke u nisur nga historia jonë kombëtare, si mendoni, çfarë kanë përdorur më tepër shqiptarët: librin apo pushkën? Cilat kanë qenë shkaqet që e kanë shtyrë në këtë zgjedhje?

Kujtimet

- 1 Pemëshitësi bën dy vlerësime krejtësisht të ndryshme për fëmijët, në dy momente të ndryshme. Gjejini ato në tekst dhe shpjegoni ndryshimin ndërmjet tyre.

- 2 Si do të silleshit ju, nëse do të gjendeshit në vend të fëmijëve, atë ditë me shumë erë?

- 3 Çfarë ndjesish ju krijohen, teksa lexoni pjesën e dytë të tekstit? Si mendoni, a është fëmijëria periudha më e bukur e jetës? Pse?

- 4 Cilat lojëra ju pëlqenin më shumë në fëmijërinë e hershme? Po tani?

Një jetë e vështirë

- 1 Rendit vështirësitet që kalon bima për t'u rritur.



- 2 Gjeni në tekst dhe shkruani fjalët që përshkruajnë ndjesi dhe sjellje të bimës, të cilat janë karakteristike për njeriun.

Ndjesi	Sjellje
e mjerë	qau

- 3 Sipas jush, ky është një tekst letrar apo joletrar? Pse? Në këtë tekstu, mesazhi përcillet si informacion apo si ndjesi?

Kthimi i Skënderbeut në Krujë

- 1 Shpjegoni me fjalë të tjera shprehjet e figurshme të renditura më poshtë.
as nam, as nishan

nuk bëri as gëk, as mëk

nuk mbeti më këmbë osmani

po rrinë sus

më goditi me thikë pas shpine

e kishin provuar në kurrit

- 2 Gjeni të gjitha fjalitë pyetëse që përmban teksti. Cila prej tyre i drejtohet lexuesit?
-
-
-

- 3 Duke u nisur nga thënia "Zhvishi rrobat e zisë që ke mbajtur veshur për aq vjet!", tregoni konceptohet Arbëria gjatë luftës.
-
-
-
-
-
-
-
-

Komandanti i klasës

- 1** Jepni mendimin tuaj se cilat janë detyrat kryesore të senatorit/es të klasës.

- ## **2 Kur quhet i suksesshëm një senator/e klase?**

Një medalje për madhështinë

- ## 1 Përgjigjuni me shkrim pyetjeve të mëposhtme.

Çfarë mendimi krijoni për Agustinin, kur merrni informacionin e parë për të?

Çfarë mendimi krijoni për Agustinin, kur drejtori i jep çmimin?

Cili është mendimi juaj personal për Agustinin?

- 2** Shkruani një tekstu letrar të shkurtër për vlerën e humanizmit.

Bora e fëminisë

- 1 Përshkrimet janë të pasura me mbiemra dhe ndajfolje. Plotësoni tabelën e mëposhtme dhe shpjegoni pse shumë nga mbiemrat përdoren radhë, njëri pas tjetrit.

Mbiemra	Ndajfolje

- 2 A rriten sot fëmijët "pa tutë" si atëherë? Çfarë ka ndryshuar në ditët e sotme, krahasuar me vitet e fëmijërisë së autores?

- 3 Përshkruani kujtimet më të bukura që keni nga fëmijëria.

Purpuranti

- 1** Gjeni elementet në bazë të të cilave "Purpuranti" klasifikohet prozë historike.

- 2** Interpretoni kuptimin simbolik të këngës në tregim. Po fëmija, çfarë simbolizon?

- 3** Komentonin thënien: "Ne kemi rrënje në këtë tokë dhe nuk shkulemi kurre".

Shuarja e humorit

- 1** E vërtetë apo e gabuar? Shënoni me ✓

Letra e rrëfimtarit	V	G
e thjeshtë		
me humor		
pa nënkuptime		
emotive		
me gjuhë teknike		
me nota kritike		

Letra e Zalos	V	G
me nota kritike		
me humor		
me terma formalë		
e ftohtë		
me gjuhë teknike		
emotive		

- ## **2 Shkruani mesazhin e kësaj pjese.**

- ### 3 Si e kuptoni titullin "Shuarja e humorit"?

Liliputët

- 1** Gjuha e kësaj pjese është e figurshme. Shpjegoni kuptimin e shprehjeve të mëposhtme dhe shënojini në fletore:

ata iu qepën shkëmbit

ndan qimen më katersh në matematikë e në mekanikë

ta vinte kokën në trastë

po roitnин si bleta

- 2** Liliputët kishin përmasa shumë të vogla, por kjo nuk i pengonte ata në jetën e tyre. Sa të rëndësishme janë përmasat në jetën e një njeriu? Argumentoni mendimin tuaj.

Të rrethuar nga ujqit e kuq

- 1 Shpjegoni kuptimin e frazave të mëposhtme:

...të shtrirë në shtratin e trashë me tërfil

...një qetësi e madhe mbretëronte

...në atë terr të heshtur

- 2 Roberti, ndonëse në moshë të re, nuk shfaq shenja frike. Si e gjykon si sjelljen e tij? Çfarë vlerash nxjerrin në pah veprimet e këtij djaloshi? Shkruani mendimin tuaj.
-
-
-
-
-
-

- 3 A ju ka ndodhur ndonjëherë të kaloni situata të vështira? Si jeni ndier?

Çfarë keni bërë? Përshkruani shkurt një rast të tillë.

Përleshja e kryetrit me kryepiratin

- 1 Shpjegoni kuptimin e figurshëm të këtyre shprehjeve:

Kur kollitej, sikur bubullinte.

Verën e pinte si ujë.

Gjaku kish skuqur detin.

Mund të zinte të gjallë edhe peshkaqenin.

Kudo që shkelte, nuk mbinte më bari.

- 2 Fëmijët kishin dëgjuar gojëdhëna për Gjonbabën. Për kë krijohen gojëdhënat në përgjithësi? Si mendoni, çfarë tiparesh ka një personazh gojëdhënah?
-
-
-
-
-
-

- 3 Ç'përfaqëson figura e Gjonbabës dhe Rusman El Namsurit në sytë e fëmijëve?
-
-
-
-
-
-

Nëndhesja

1 Si e kuptioni shprehjen e Partinit që bionika rrëmben “patentat e gjalla” të natyrës?

2 Si mendoni, pse janë mbështetur shkencëtarët në tiparet e lakuriqit të natës për ndërtimin e nëndheses?

3 Argumentoni pse Partini e quan bionikën “grua”. Çfarë arrin të ndërtojë bionika ndërmjet zbulimeve shkencore?

Një mik i paharruar

- 1** Në listën e mëposhtme të fjalëve, zgjidhni atë që ka kuptim të përafërt me fjalën e nënvizuar dhe shkruajeni në krah të saj. Pesë fjalë janë të tepërtë.

Të dhëna, jehonë, inat, detaje, flijohen, dukej, zemërartë, buçimë, mbarojnë, shpirtgjerë, zemërim.

Ky astronom e shpalli zbulimin e tij me <u>bujë</u> të madhe përpara një kongresi ndërkombëtar të astronomisë.	
Tregova kaq shumë <u>hollësi</u> rreth asteroidit B 612, madje shënova edhe numrin e tij, pikërisht për shkak të të rriturve, që vdesin për shifra.	
Tregova kaq shumë hollësi rreth asteroidit B 612, madje shënova edhe numrin e tij, pikërisht për shkak të të rriturve, që <u>vdesin</u> për shifra.	
Nuk duhet t'u mbajmë <u>mëri</u> .	
Fëmijët duhet të jenë mjaft <u>zemërgjerë</u> me të rriturit.	
Për ata që e kuptojnë jetën, kjo do të <u>tingëllonte</u> shumë më e vërtetë.	

- 2** Lexoni me kujdes paragrafin e mëposhtëm.

Prandaj, nëse ne u themi: "Prova që princi i vogël ka ekzistuar, éshtë se ai ishte i mrekullueshëm, se qeshte, se donte një dele. Kur dikush kërkon një dele, do të thotë se kjo éshtë një provë që ai ekziston", ata do të mbledhin supet dhe do të na trajtonë si fëmijë të vegjë! Por, sikur t'u themi: "Planeti prej nga ai vinte éshtë asteroidi B-612", atëherë do të binden dhe nuk do të na bëjnë më pyetje.

Kujt i referohet përemri ne dhe trajta e shkurtër (*neve*) na e po këtij përemri në rasën dhanore? Qarkoni alternativën e saktë.

- | | |
|-----------------|------------------------------|
| a) të rriturve; | b) rrëfimtarit dhe fëmijëve; |
| c) fëmijëve; | ç) rrëfimtarit dhe lexuesve. |

- 3** Si e kuptioni thënien "Jo të gjithë mund të kenë miq"? Sa të rëndësishëm janë shokët dhe shoqet në jetën tuaj?
-
-
-
-
-
-
-
-
-

Borfor – provat e Askanos

- 1** Në thëni e mëposhtme, zëvendësoni me një sinonim fjalën/fjalët me të pjerrëta dhe tregoni se cilës pjesë të ligjërâtës i përket ajo (emër, folje, mbiemër, ndajfolje etj.).

një shpërthim <i>tmerrësisht</i> i fortë		
<i>dimension</i> tjetër		
përmasa <i>gjigante</i>		
<i>kishte ngelur</i> i habitur		
<i>Pavarësisht</i> se i dukej		
Dardali <i>u hutua</i>		

- 2** Ai keni dëgjuar më parë emrat e personazheve të këtij teksti? Po fjalët *ikeas* dhe *mertef*? Përse autor i krijon fjalë të tillë dhe si lidhet ky krimi me tekstin fantastik?

Roboti që donte të flinte

- 1 Shpjegoni me fjalë të tjera këto shprehje të figurshme.

po flinte për shtatë palë qejfe _____
e ndau mendjen _____ pa i shkuar mendja _____
u tund vendit _____

- 2 Plotësoni tabelën rreth ngashmërive dhe ndryshimeve mes robotit Katerino dhe njerëzve.

Ngashmëritë	Ndryshimet
U pëlqente të flinin. _____ _____ _____ _____ _____	Katerinoja nuk ishte qenie njerëzore, por makinë. _____ _____ _____ _____ _____

- 3 Plotësoni tabelën me punët që bënte roboti Katerino, duke treguar në këtë mënyrë mendimin që keni rreth tyre.

Punë të dobishme	Punë të mërzitshme	Punë të pazakonta ose komike

- 4 Duke iu referuar tri ligjeve të robotikës, cilat ligje shfaqen më së shumti në tregimin “Roboti që donte të flinte”?

Tri ligjet e robotikës janë:

1. Roboti nuk ka mundësi ta lëndoje njeriun apo, duke mos vepruar, të lejojë që njeriu të dëmtohet.
2. Roboti duhet t'u bindet urdhrale që i japid njerëzit, përvèç atyre që bien ndesh me Ligjin I.
3. Roboti duhet ta mbrojë ekzistencën e vet për sa kohë që kjo mbrojtje nuk është në kundërshtim me Ligjin I ose Ligjin II.

Isak Asimov (autor i shumë veprave fantastike rreth robotëve)

Busulla e artë

- 1** Si përshkruhet në tekstu vetmja e Lirës? A mendoni se dhunitë e veçanta i bëjnë heronjtë të ndihen ndonjëherë të vëtmuar?

- 2** Duke u nisur nga përshkrimi i Lirës në fragmentin e mësipërm, si e imagjinoni pamjen fizike të saj?

Kur nëna ime...

1 Kjo poezi vjen në formën:

- a) e këshillave;
- b) e dëshirave;
- c) e lutjeve;
- ç) e premtimeve.

2 Plotësoni elementet e metrikës së kësaj poezie:

Strofa: _____

Rima: _____

Vargu: _____

3 Në strofën e fundit të kësaj poezie, autor i do të na tregojë se:

- a) duhet të kujdesemi për ata që janë më të vegjël se ne;
- b) lumturia është e plotë kur e ndajmë atë me të dashurit tanë;
- c) në çdo hap të jetës, ne duhet të kemi pranë familjarët tanë;
- ç) më të mëdhenjtë na ndihmojnë ne, ne ndihmojmë më të vegjlit.

4 Figura letrare në vargjet: *bëhet kitarë/anije/valë*, është:

- a) epitet;
- b) krahasim;
- c) inversion;
- ç) metaforë.

5 Shkruani nga një fjali përbledhëse për kuptimin e çdo strofe.

1 _____

2 _____

3 _____

4 _____

5 _____

6 _____

Shpell' e Dragobisë

- 1 Gjeni elementet që e bëjnë këtë poezi të konsiderohet si elegji.

- 2 Në vargjet e mëposhtme, evidentoni ritmin, figurat letrare që janë përdorur dhe efektin që shkaktojnë te lexuesi.

*Atje nisi, atje mbaroj,
Atje krisi, atje pushoj,
Rrufe-shkab' e Malësisë,
Në një shkëmb të Dragobisë.*

- 3 Krahasoni figurën e Bajram Currit me figurën e një heroi tjeter kombëtar.
Dalloni ngjashmëritë mes tyre.

Vrull

- 1 Gjeni dhe shkruani në fletore fjalët kyçë të kësaj poezie.

- 2 Çfarë synon të tregojë poeti me shprehjet e mëposhtme?

- zemra do t'më plasë...
- hapet deti..
- shqetësimi zemrën çjerr...

- 3 Shpjegoni ndërtimin e figurshëm të këtij vargu: *I helmuar e shkoj jetën te ky dhe.*

- 4 A mendoni se me kalimin e kohës, njeriu mund ta harrojë vendlindjen e tij?

Kosovës

1 Plotësoni tekstet e mëposhtme me fjalët e duhura.

Aliteracioni është një figurë letrare që karakterizohet nga _____ e njëpasnjëshme e së njëjtës _____, _____, bashkëtingëlloreve ose togjeve të tingujve _____ në një varg ose në një fjali.

Anafora është _____ e një _____ ose fraze në _____ të vargjeve. Si figurë stilistikore _____ shprehësinë dhe veçon _____ e pjesës që përsëritet apo të pjesës që del e re pas _____.

Epifora është _____ e së njëjtës _____ a frazë në fund të çdo
të poezisë, për t'i dhënë atij _____. Epiforë quhet edhe
që shërben si _____ ose si _____ pas çdo strofe.

2 Reflektoni rreth vargjeve të mëposhtme.

*Po del para botës Kosova heroike
Me zana e dragonj... O, na po gjallnojmë!
Po del në hapsirë me krahët e një sprije –
Eni t'këndoymë!*

Shkëndijë e diellit ndaj manushaqes

- 1 Cili është kuptimi i vargjeve të mëposhtme? Qarkoni alternativat që ju duket se qëndrojnë, duke argumentuar zgjedhjen tuaj.

Pa shiko lulet e tjera, / q'u çel e u lulëzuan...

- a) Ne (atdhedashësit) nuk duhet të rrimë indiferentë, por të marrim shembull nga zhvillimi e përparimi i vendeve të tjera që nuk janë të pushtuara.
- b) Lulet e tjera kanë çelur e janë lulëzuar, ndërsa manushaqja ende jo.
- c) Poeti dëshiron që manushaqja të shikojë se si çelin lulet e tjera.

O lulëz' e Perëndisë, / që të mbolli vetë Zotin...

- a) Manushaqen e ka mbjellë vetë perëndia.
- b) Atdheu i poetit është i vogël, por i lashtë sa vetë bota.
- c) Lulja e manushaqes është një lule e vogël.

Shpendëra, hithëra, ferra / përsipër të kanë rënë...

- a) Barëra të këqija kanë mbirë rreth e rrotull manushaqes.
- b) Pushtuesit dhe tradhtarët e mbajnë vendin nën kontroll.
- c) Manushaqja mezi e mban peshën e barërave të këqija që i kanë rënë sipër.

Po mos u tremb, bëhu trime / edhe ki durim e shpresë

- a) Manushaqja duhet të presë sa t'i pastrojnë barërat e këqija.
- b) Ne (atdhedashësit) nuk duhet të kemi frikë, por të bëhem trima dhe ta presim ndryshimin me durim.
- c) Me durim arrihet çdo gjë.

- 2 Po sot, në ç'gjendje është atdheu ynë? Me çfarë mbiemrash do ta karakterizonit atë? Lidhni fjalën *manushaqe* me mbiemrat që do të përzgjidhnë, më pas përgjigjuni pyetjes.
-
-
-
-
-
-
-
-
-
-

Mëma

- 1 Si i karakterizon poeti ata që nuk e njohin vlerën e vërtetë të nënës? Plotësoni:
është pa ndjenjë

- 2 Interpretoni vargjet:

*kush s'di vlerën e një nëne,
është pa ndjenjë e shpirtmizor,
bir skëtërre e frymë nëme,
ësht' i vetes tradhëtor!*

- 3 Krahasoni nënën e kësaj poezie me nënën tuaj.

Shqiponja

- 1 Në poezi thuhet "qiellin arbëror". Si mendoni, pse poeti ka bërë këtë zgjedhje?

- 2 Në togfjalëshin: *Shqiponja e mprehtë, epiteti e mprehtë, nënkupton lidhjen me sqepin e mprehtë apo mendjen e mprehtë?*

- 3 Kjo poezi është ndërtuar në bazë të disa metaforave. Gjeni tri prej tyre dhe analizoni mënyrën se si janë ndërtuar.

- 4 Si e kuptioni krahasimin: *Qëndron si roje – kurorë?*

- 5 Vlerësoni dhe komentonи mënyrat dhe zgjedhjet stilistike të autorit.

Zgjedhjet stilistike të poetit	Komenti	Vlerësimi im

Të dua baltë shqiptare

1 Cili është qëllimi i kësaj poezie?

a) T'i thurë vargje dashurisë për atdheun.

b) _____

c) _____

2 Përse Kuteli shkruan "jam brenda teje/ s'dal dot/ se s'dua!"? A mund të interpretohet kjo si një pamundësi dhe mungesë dëshire për t'u shkëputur nga identiteti i vet?

3 Interpretoni vargjet "se thellë jam këtu/ brenda teje/ gjer mbi gju/ gjer mbi bel/ e gjer mbi krye", duke u përqendruar te pjesët e trupit që janë përmendur. (Gjuri, si vendi ku është fuqia e njeriut për t'u mbajtur më këmbë e për të ecur. Beli, si pjesa më e ngushtë e trupit të njeriut, poshtë kraharorit, dhe kryet (koka), si pjesa më e sipërme e trupit të njeriut dhe qendra e të menduarit dhe e të arsyeturit).

4 Një fjalë e urtë thotë: "Këmbë për baltë, gojë për mjaltë". Kuptimi i saj është: Ai që punon, ka edhe të hajë. A mendoni se fala *baltë* në këtë poezi mund të interpretohet edhe si punë, përpjekje për t'u pasuruar e për të shtuar mirëqenien?

Leni lumejt...

- 1** Ktheni këto fjalë nga forma dialektore në gjuhën standarde:

Lagun - _____

Kambët - _____

Gruni - _____

Ullini - _____

Gjansinë - _____

Vashat - _____

- 2** Jeni pro apo kundër spontanitetit në përditshmëri? Paraqitni këndvështrimin tuaj.

Besëlidhja shqiptare

- 1** Shqiptarëve u është dashur shpesh të përballen me situata tragjike për kombin e tyre. Përmendni disa prej tyre dhe pasojat që kanë pasur.

- 2** Interpretoni fjalët e Abdylit në lidhje me situatën: "Të vdesim duke luftuar, të mos rrojmë duke u zvarritur!".

I sëmuri për mend

- 1 Zbërtheni dy karakteret kryesore të pjesës së shkëputur nga komedia, duke i vënë përballë njëri-tjetrit.

Argani	Tuaneta
Me mendje të turbullt	Me mendje të kthjellët

- 2 Vlerësoni emocionet tuaja në lidhje me Arganin. Ky personazh ju bën të qeshni, ju bën të ndieni keqardhje për të apo të dyja?

- 3 Molieri i krijonte komeditë duke goditur fenomene ose karaktere të kohës së tij, megjithatë veprat e tij mbeten bashkëkohore. Çfarë mesazhi merrni nga kjo komedi? A nnihni njerëz që i ngjajnë Arganit në fiksimin e tij?

Kafshët fantastike dhe ku mund të gjenden

- 1 Interpretoni këtë fragment të tekstit: "XHEJKOBI merr frymë thellë, i kënaqur. Ndodhet në parajsë!" Për çfarë arsyje ndihet kështu Xhejkobi?

- 2 Si mendoni, çfarë është krijesa që angullin? Kafshë shtëpiake, shpend apo kafshë magjike?

- 3 Çfarë rubrikash dhe shkrimesh mund të kenë revistat "Miku i magjistares", "Magjistarja moderne" dhe "Shndërrimi Sot", që motrat Golldstin kanë në apartamentin e tyre?

Prometeu i mbërthyer

- 1 Përshkruani gjendjen në të cilën ndodheshin njerëzit përparrë se t'i ndihmonte Prometeu.

- 2 Renditni njëra pas tjetrës njohuritë dhe shpikjet që u mësoi Prometeu njerëzve.

- 3 Kori, pasi ka dëgjuar sesi i ka ndihmuar Prometeu njerëzit, shprehet: "Kam shpres' se kur nga prangat të çlirohen/ me Zeusin vet' do matesh në fuqi". A është ky një parashikim për të tërë tiranët? Si është fundi i atyre që shtypin drejtësinë dhe përparimin?

- 4 Shpesh thuhet se Prometeu është një martir i njerëzimit. Shpjegoni këtë përcaktim, duke u nisur nga tragjedia e Eskilit.

Nanë e dashtun!

1 Shkruani fjalët ose shprehjet sinonimike për secilin rast të dhënë.

të liga _____, të pashoq _____, e zorshme _____, burrnisht _____, pjellës sate _____, me qitë hapin _____, e ka lypë puna _____, nuk don me ditë _____, krejni e pashoqe _____, pëlcas _____.

2 Çfarë kuptimi kanë fjalitë e mëposhtme? Qarkoni alternativën e saktë.

Jam shumë i lumtun që për këtë pikë, pra, për mërzinë tandem, shpirtin e kam të fjetun.

- a) Autori nuk shqetësohet se mos nëna mërzitet.
- b) Autori e di që nëna është e fortë dhe nuk mërzitet.
- c) Autori e këshillon nënën të flejë, për të mos ndier mërsi.

Ti je nji lis, që nuk don me ditë për fërfllazat e forta. Bile, nji lis, madhështia e të cilit del në pah bash kur merr mot me fërfllazë.

- a) Autori mendon se nëna e tij është më e fortë se lisi.
- b) Autori e krahason nënën me lisin dhe vështirësitetë me fërfllazat.
- c) Tani që ka vështirësi, mund të kuptohet më mirë sa e fortë është nëna.

Në përfytyrimet e mia të gjalla, këtu në tretdhë, të shoh tuj ecë me atë krejnинë tandem të pashoqe, sa herë që nisesh me e pa djalin tand në burg, e rrugës të bjen me u shpërndrrue me anmiq të mëdhenj e të vegjël të pjellës sate.

Dhe dije se krejnia jote përballe fërfllazës së sotme, asht helmi ma i fortë për anmikun.

- a) Qëndrimi krenar i nënës përballe kësaj situate të vështirë, është si helmi për armikun.
- b) Armiku do ta helmojë nënën krenare.
- c) Armiku është krenar për fërfllazën që ka shkaktuar.

3 Interpretoni thënien "si të gjitha ato nana trimnesha e fisnike shqiptare, të cilat, kur e ka lypë puna e vatanit, s'ë kanë kursye e s'ë kanë kajtë me lot jetën e djemve të tyne dhe kanë këndue kur kanë kukatë qyqet".

4 Autori paralelizon vështirësitetë dhe sfidat jetësore me kushtet dhe dukuritë atmosferike. Gjeni cilat janë ato dukuri atmosferike që përmenden dhe çfarë simbolizojnë.

Idriz Ajeti, babai i albanologjisë në Kosovë

- 1** Gjeni fjalë të tjera që janë sinonimike me fjalët me të pjerrëta, në mënyrë të tillë që shprehjes të mos i ndryshojë kuptimi.

Shembull: Ka qenë e admirueshme sjellja e tij. – Ka qenë e respektueshme.

Ishte në ballë të veprimtarëve për të drejtat kombëtare. _____

Këtë e dëshmon gjuha e tij karakteristike _____

Ishte njëri nga protagonistët. _____

... kundër *lajthitjeve dhe diletantizmit* _____

Kjo mbrojtje e shqiptuar fuqishëm ..._____

... origjinën antike të shqipes _____

- 2** Si mund të formulohen ndryshe fjalitë e shkëputura nga teksti? Qarkoni alternativën e saktë.

Të gjithë brezat e studentëve dhe të studiuesve të shqipes në Prishtinë janë nxënës të drejtpërdrejtë apo të ndërmjemë të tij.

- a) Ajeti ka qenë drejtpërdrejt profesor i studiuesve dhe studentëve të shqipes ose profesor i profesorëve të tyre.
- b) Ajeti ka qenë ndërmjet studentëve dhe studiuesve në Prishtinë.

Ka qenë një reagues i rreptë, konciz dhe i pakompromis kundër lajthitjeve dhe diletantizmit në fushën e studimeve shqiptare.

- a) Sa herë që në studimet shqiptare bëheshin gabime ose shfaqeje paaftësi, Idriz Ajeti reagonte rreptësisht, në mënyrë të përbledhur dhe pa bërë ujdi.
- b) Idriz Ajeti ishte konciz për të mos bërë lajthitje në studimet e tij.
- c) Idriz Ajeti reagonte ashpër ndaj atyre që bënин ujdi në fushën e studimeve.

Nderimi dhe kujtimi për të do të janë të përhershëm sa të jetë shqipja.

- a) Për sa kohë të ekzistojë e të flitet gjuha shqipe, të gjithë do ta nderojnë dhe do ta kujtojnë Idriz Ajetin.
- b) Idriz Ajeti do të kujtohet dhe nderohet përherë në gjuhën shqipe.

- 3** A mendoni se është i mjaftueshëm aq informacion sa përmban ky tekst rreth jetës dhe veprës së Idriz Ajetit? Argumentoni përgjigjen tuaj.
-
-
-
-

- 4 Lexoni me vëmendje fragmentin:** "Idriz Ajeti e ka adhuruar Eqrem Çabejn si personalitet dhe si studiues të albanologjisë. Ai vetë ka qenë i çmuar dhe i nderuar lart nga Çabej për veprimtarinë e tij shkencore e kombëtare. Ka qenë i admiruar nga studentët e tij, të cilëve u ka mësuar shkrimin e bukur të shqipes. E kanë lexuar ata, por i ka lexuar edhe ai me vëmendje të jashtëzakonshme". Çfarë tregon fragmenti në lidhje me marrëdhënien nxënës-mësues, student-profesor?

Erza, shqiptarja me famë botërore nga muzika drejt kinematografisë

- 1 Plotësoni tabelën me emra personalitetesh, vendesh apo ngjarjesh që përmenden në intervistë.

Personalitete	Vende	Ngjarje

A janë realë apo të trilluar emrat e tabelës së mësipërme?

- 2 A është informues dhe nxitës titulli i intervistës? Nëse do të ishte në dorën tuaj, si do ta kishit titulluar ndryshe këtë intervistë?
-
-
-

- 3 Çfarë pyetjesh të tjera do t'i bënit ju Erzës? A do të donit ta kishit të ftuar në një nga aktivitetet tuaja shkollore?
-
-
-
-
-

Gjirokastra

1 Shënoni me ✓. Funksioni i këtij teksti është:

- Të bindë lexuesin që të vizitojë Gjirokastrën.
 - Të përshkruajë me detaje qytetin.
 - Të përshkruajë përjetimet e autorit në Gjirokastër.
 - Të shpjegojë informacionet rreth qytetit.

2 Gjeni fjalë e shprehje sinonimike me shprehjet e mëposhtme.

Nuk e ka shogin. _____

Janë në zë. _____

Nuk e kanë për gjë. _____

Në ditë të kremtesh... _____

Nuk gjen gjetiu mbi dhé.






3 Cilat aspekte që përshkruhen në tekstu për Gjirokastrën vlejnë edhe sot, gati 3 shekuj pasi
është shkruar ky udhëpërshkrim?

Kulti i disa gjallesave të natyrës

1 Për secilën thënie, shënoni ✓ nëse është i vërtetë ose ✗ nëse është i gabuar.



- Dikur, kafshët, shpendët dhe insektet e kultit nuk duhej të vriteshin nga njerëzit apo gjahtarët.
- Sorkadhja, kur ishte në çastet e fundit të jetës, e kthente kokën nga perëndimi.
- Dhia e egër konsiderohej si hyjni e malit.
- Shqiponja nderohet shumë nga shqiptarët dhe Edit Durhami.
- Nuk besohej se ishte problem të mallkohej bleta.
- Sipas besimeve të hershme, bleta nuk bën më mjaltë, nëse ai që shkon të mbledhë mjaltin, nuk është i pastër dhe i larë mirë.



2 Teksti përban shumë emra vendesh. Kjo ndodh me qëllim që:

- a) të informohet lexuesi saktësisht ku shfaqet një kult i caktuar;
- b) argumenti të jetë bindës për lexuesin;
- c) të përshkruhen sa më mirë dhia e egër, bleta, sorkadhja dhe shqiponja;
- ç) të rrëfeshet raporti i shqiptarëve me kafshët e kultit.

Qarkoni alternativën e duhur.

3 Në dy raste, autor i referohet burimeve të tjera për të mbështetur atë që po thotë. (Një herë Eposit të Kreshnikëve dhe një herë Edit Durhamit). Për çfarë shërben diçka e tillë? Shënoni me ✓.

- Për ta bërë më të besueshëm informacionin.
- Për ta bërë më të bukur tekstin.
- Për ta plotësuar informacionin që teksti përcjell.
- Për ta ngulitur informacionin në kujtesën e lexuesit.

4 Shkruani kuptimin e thënieve të mëposhtme. Këshillohuni me "Fjalorin e gjuhës shqipe" nëse e shihni të nevojshme.

Ishte dre

Ngul këmbë si dhia

U bënë si këmbët e dhisë


Bleta di si bëhet mjalta

I ka dalë gjeli kaproll

Shqiponja nuk ha miza

Zogjtë

- 1** Lexoni pjesën dhe plotësoni hartën kuptimore të mëposhtme.



- 2** Plotësoni, duke iu referuar informacioneve në tekstin:

Studimet e kryera rreth objektit:

Botime rreth temës:

Konkluzione t  nxjerra nga studimet rreth tem s:

- 3** A mbyllt pjesa me një konkluzion të qartë nga ana e shkencëtarëve? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Gjashtë këshilla për të rritur pasionin për të lexuar

1 Për çfarë na këshillon ky tekst? Shënoni me ✓.

- Për të arritur rezultate të larta në mësime.
 - Për të shkruar një tekst udhëzues.
 - Për të rritur pasionin tonë për leximin.
 - Për të hartuar përmblehdjen e një teksti.
 - Për të blerë sa më shumë libra.
 - Për t'u sugjeruar sa më shumë libra shokëve dhe shoqeve.

2 Cila nga këshillat e mësipërme ju vlen më shumë? Pse?

3 Çfarë këshillash do të jepnit për të arritur të njëjtin qëllim me autorin e këtij teksti?

Përparësitë dhe të metat e shpyllëzimit

1 Shënoni me ✓. Në këtë tekst jepen:

- opinione për çështje të ndryshme;
- opinione të ndryshme për të njëjtën çështje;
- kritika për mosveprimin ndaj shpyllëzimit;
- sugjerime se çfarë mund të bëhet me tokën e lënë djerrë.

2 Çfarë shprehet në hyrjen e tekstit? Shënoni me ✓.

- Paraqitet çështja që do të trajtohet.
- Paraqiten argumentet kundër shpyllëzimit.
- Argumentohet kundër prerjes së pemëve.
- Jepen zgjidhje për të shmangur shpyllëzimin.

3 Shkruani:

Një argument që sjell një fakt konkret:

Një argument që ju duket bindës:

Një argument që nuk ju duket bindës:

4 Argumentet pro dhe kundër shpyllëzimit, në këtë tekst, jepen të renditura me numra. Çfarë roli luan një paraqitje e tillë?

- E bën më të lehtë për lexuesin që t'i mbajë mend përparësitë dhe të metat.
- Shmang përdorimin e fjalëve dhe shprehjeve lidhëse si: së pari, së dyti, gjithashtu, krahas kësaj, për më tepër, një tjetër argument.
- E paraqet në mënyrë më të përbledhur dhe më të thjeshtë informacionin.
- Numri i argumenteve pro dhe kundër shpyllëzimit është i njëjtë.

5 Sipas jush, vetëm pse ka disa pemë të sëmura ose në prag tharjeje, a është e justifikueshme që të shpyllëzohet e gjithë zona?

- 6** A ndodh gjithmonë që pemët e prera të zëvendësohen me mbjelljen e pemëve të reja? Çfarë tregon kjo për pasojat e shpyllëzimit?

- 7** Rishkruani përparësitë ose të metat e shpyllëzimit, duke i lidhur argumentet e dhëna përmes fjalëve e shprehjeve lidhëse dhe jo të renditura me numra, siç janë dhënë në tekst.

Fjalë e shprehje që mund të përdorni janë: së pari, së dyti, gjithashtu, po ashtu, krahas kësaj, për më tepër, një tjetër argument që jepet etj.

A duhet të lejohen celularët në shkolla?

1 Shënoni me ✓ pohimin e saktë dhe korrigjoni ato të pasaktat.

- Studimi amerikan ka treguar se ndalimi i cellularëve në shkolla është dobiprurës për rezultatet në mësime.
- Nxënësit me rezultate më të dobëta merrnin nota më të mira pasi i linin cellularët në shtëpi.
- Prindërit që duan të zhvillojnë perspektivat akademike të fëmijëve, nuk duhet t'i lënë ata të marrin telefonat cellularë në shkollë.
- Sipas studimit, nxënësit mund t'i marrin telefonat cellularë me vete në shkollë.
- Nxënësit mesatarë përfitojnë dyfish më shumë, krahasuar me nxënësit e mirë, kur shkolla nuk lejon përdorimin e cellularit.
- Numri i shkollave që nuk lejojnë përdorimin e cellularëve në klasë ka ardhur përherë e në rritje.
- Cellulari mund të përdoret kur nxënësit nuk kanë kompjutera në shkollë.

2 Funksioni i këtij teksti është:

Po Jo

Të bindë lexuesin për çështjen e moslejimit të cellularëve në shkollë.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------

Të paraqesë informacione rreth studimeve për përdorimin e cellularëve në klasë.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------

Të përshkruajë të dhënat e humertimeve të kryera.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------

Të shpjegojë informacionet shkencore rreth lejimit të cellularëve në shkollë.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------

3 Shënoni me ✓ pohimin e saktë.

Fjalët dhe shprehjet *por, nga ana tjeter, megjithatë*, që përdoren në tekst, shërbejnë:

- për të lidhur ide/ argumente të ndryshme ndërmjet tyre;
- për të lidhur ide/ argumente të ngjashme ndërmjet tyre.

Fjalët dhe shprehjet *krahas këtyre, gjithashtu, po ashtu*, që përdoren në tekst, shërbejnë:

- për të shtuar ide/ argumente të tjera në vijim;
- për të kundërvënë idetë/ argumentet mes tyre.

4 Përse përdorimi i cellularëve në klasë është shqetësues për mësuesit?

5 Sipas jush, a qëndrojnë argumentet që jepen në lidhje me lejimin e cellularëve në shkollë?

Vendi me më shumë libra sesa banorë

- 1 Si nis përshkrimi i vendit? Çfarë paraqitet në paragrafin hyrës?

- 2 Cilat shqisa përmenden në tekst se duhen vënë në punë për të përjetuar qytetin e librave? Çfarë vlere ka kjo për përshkrimin e vendit?

- 3 Plotësoni tabelën.

Mbiemra që përdoren për të përshkruar qytetin	Mbiemra që përdoren për të përshkruar librat

- 4 Përse thuhet që qyteza e Mundalit është thuajse surreale?

Ndërrimet historike të fonemave në gjuhën shqipe

1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.

Disa ndryshime fonemore mund të shpjegohen vetëm me anë të _____, që kanë vepruar kohë më parë në gjuhë, por që në ditët e sotme _____ më si dikur.

Një pjesë e mirë e ndërrimeve historike shfaqen kryesisht në _____ të së njëjtës fjalë.

Shumë ndërrime fonemore vihen re në formimin e _____ të foljeve.

Disa ndërrime dalin në _____ që kanë të njëjtën rrënjen.

Ndërrimet e fonemave nuk kanë _____, pra nuk shërbejnë për të dhënë _____ gramatikore.

Me _____ kuptojmë trajtat e ndryshme që merr fjala sipas kategorive gramatikore të saj.

2 Lidhni me vijë llojin e ndërrimit të zanores me përshkrimin përkatës. Shkruani nga një shembull për secilin rast.

Kontrakzioni	Kemi atëherë kur zanoret më të hapura bëhen më të mbyllura, ose kur zanoret e prapme bëhen më të përparme.
--------------	--

Përzierja	Kemi në rastet kur zanoret më të mbyllura bëhen më të hapura, ose kur zanoret e përparme bëhen më të prapme.
-----------	--

Apofonia	Ndodh në ato raste kur zanoret -ë, -e bashkohen për të dhënë zanoren -a.
----------	--

Metafonia	Mbledhja ose reduktimi i dy zanoreve në kontakt me njëra-tjetërën në një diftong ose në një zanore të gjatë.
-----------	--

3 Lidhni rastin e ndërrimit të bashkëtingëlloreve me shembujt e dhënë.

k-q	brumbull – brumbuj shekull – shekuj
g-gj	fik – fiq plak – pleq
s-t	bir – bij flamur – flamuj
ll-j	shteg – shtigje shelg – shelgje
r-j	marr – mora çjerr – çora
r-rr	mas – mat shëtis – shëtit

Përdorimi i drejtë i dy pikave, thonjëzave, pikëpresjes dhe kllapave

1 Përcaktoni rastin e përdorimit të dy pikave në fjalitë e mëposhtme.

Duhen bërë disa gjëra: të pastrohen mjediset, të mblidhen valixhet, të fiken dritat.

Majë një peme cicëronte një zog: ciu-ciu-ciu.

Shkruhen me –ë në fund fjalët: i gjatë, i lartë, i gjerë.

Në ballin e tij lexoheshin qartë ndjenja të tilla, si: patriotizmi, dashuria, humanizmi.

2 Përcaktoni rastin e përdorimit të thonjëzave në fjalitë e mëposhtme.

Nëna u kthye nga ne dhe foli: "Nxitoni se do të na niset treni!"

Fjala "atdhe" është nga më të dashurat për ne.

Vargjet "Mëmëdhe quhet toka/ku më ka rënë koka" nuk i harron asnjë.

Shkolla "Dora d'Istria" fitoi olimpiadën e matematikës.

3 Përcaktoni rastin e përdorimit të kllapave në fjalitë e mëposhtme.

Këndonte tërë ditën se i dukej vetja këngëtar i madh (?!).

Komisari: (sulet) Përpara shokë!

Disa nga anëtarët e Këshillit Studentor (KS) morën pjesë në një konferencë ndërkombëtare.

Te fusha e zezë (kështu quhej fusha ku luanim futboll) është ngritur një pallat i madh.

Eqrem Çabej (1945-1987) është një nga studiuesit më të spikatur të gjuhës shqipe.

4 Përcaktoni rastin e përdorimit të pikëpresjes në fjalitë e mëposhtme.

Në njérën anë ecnin të vegjlit; në anën tjetër qëndronin prindërit.

Dallgët edetit ungriten lart dhe u bënë sa një mal; poshtë tyre duke shin notarët që nuk trembeshin prej tyre.

Përdorimi i trepikëshit (...)

- 1** Plotësoni tabelën me shembuj të përdorimit të trepikëshit.

Rast përdorimi	Shembull
Shpreh ndërprerjen e një thënieje me qëllim nënkuptimin e vazhdimit të saj.	
Në shkurtimet e fjalëve ose datave që nuk duam t'i japim të plota ose që nuk na kujtohen.	
Për të shprehur mungesën ose vonesën e përgjigjes në dialog.	
Pas një numërimi që nuk jepet deri në fund.	
Në citime kur fjalia jepet e paplotë në fillim, në mes apo në fund të saj.	
Në vend të një shkronje, fjale, numri a shenje aritmetike që duhet gjetur.	

- 2** Tregoni se me cilin përdorim të trepikëshit lidhen rastet e mëposhtme.

„...Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. ...Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është tregues i nivelit të kësaj kulture...”

E. Çabej

- 3** Vendosni trepikëshin atje ku mungon dhe shpjegoni rastin e përdorimit përkatës.

Ja sa të mbaroj shkollën pastaj e di unë
 Ai ka lindur më dhe vjen nga
 Të gjithë po prisnin të fliste
 Muajt e vitit janë janari, shkurti
 Fillon me shkronjën A vazhdon me dhe përfundon me
 Fjalimet e gjata japin bezdi.

- 4** Shkruani një shkrim të shkurtër me 6 fiali, ku të tregohen raste të ndryshme të trepikëshit.
-
-
-
-
-
-

Fjalët me ngjyrim emocional

- 1** Në tekstin e mëposhtëm nënvizoni fjalët që shprehin ngjyrim emocional.

A e di bir pse nuk doja ta thyeje në shpirt shokun tënd? Sepse atij do t'i dukej si një qortim dhe kjo nuk do të kishte hije se ai nuk e bëri me dashje dhe veç kësaj rrobat i ndoti duke punuar. Njollat e punës nuk janë ndonjë ndyrësi, sepse puna nuk të ndot kurrë. Për punëtorin që kthehet nga puna mos thuaj kurrë: "Është i ndotur!" Thuaj: "Në rrobat e tij ai ka shenjat dhe gjurmët e punës." Këtë mos e harro! Duaje muratorin, e para se është shoku yt dhe pastaj se është biri i një punëtori!

- 2** Ndërtoni fjali me fjalët: *zemër, kokë, pëllumb*. Përdorini ato:

- a) me kuptim të drejtpërdrejtë; b) me ngjyrim emocional.

Digitized by srujanika@gmail.com

b) _____

- 3** Ndërtoni tri fjali me fjalë që emërtojnë shpendë dhe kafshë (p.sh.: lopë, dele, pëllumb etj.). Përdorini ato me ngjyrim emocional.

- 4** Ndërtoni dy fjali me fjalë që emërtojnë lule dhe bimësi (p.sh.: karafil, trëndafil etj.). Përdorini ato me ngjyrim emocional.

- 5** Ndërtoni dy fjali me fjalë që tregojnë cilësi (p.sh.: hutaq, i jashtëzakonshëm etj.) Përdorini ato me ngjyrim emocional.

Kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve

- 1** Në tekstin e mëposhtëm, nën vizoni fjalët që janë përdorur me kuptim të figurshëm.

Era nisitë fryjë prapë vetëm sot në mëngjes, pas gati trijavësh pa erë. Bisedat vërtiteshin më shumë se ndonjëherë rrëth motit. Hidheshin disa hipoteza, fjalë gjithë lëng në heshtje, frysma marrja e penguar e malit që në heshtje kërkonte ndjesë. Disa përmendën ngrohjen e planetit, të vjetrit ngritën supet duke lëshuar atë frazë të rraskapur, aq të thënë e të stërthënë saqë s'ka nevojë për koment. Ata ngritën supet, s'ka më katër stinë.

- 2** Ndërtoni fjali me kuptimet e drejtpërdrejta dhe të figurshme të fjalëve të mëposhtme.

Shembull

I. Zog (kuptimi i drejtpërdrejtë)
Një zog i bukur me krahët shumëngjyrësh fluturonte i lirë në qiell.

II. Zog (kuptimi i figurshëm)
-Sa bukur këndon ajo! Si një zog i ëmbël!

Mace (kuptimi i drejtpërdrejtë)

Mace (kuptimi i figurshëm)

- 3** Në fragmentin e mëposhtëm, nën vizoni fjalët ose grupet e fjalëve që shprehin kuptim të figurshëm.

Nën penën e shkrimtarit, vjeshta nuk zgjat shumë. Flakërima e aheve, njollat e tyre të portokallta dhe lirike, okërat e shkëlqyera të shelgjeve, jeshilet e ftohta të ngrëna nga dielli në degët e mështeknave, të kuqet masive përhapur si flakë, të kuqet si grumbuj pikash e gjembash shkëlqejnë të veçuara mes të verdhave të pemëve të tjera. Buzë rrugës, ngjyrat e gjetheve tkurren në të murrme, kurse trungjet tashmë janë në gri të trëndafiltë. Ah, kjo vjeshta! Koha mezi të del ta përshkruash!

(Emmanuelle Pagano, "Ylber hëne")

Gjuha standarde dhe dialektet

1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.

Gjuha shqipe ka dy _____: gegërishten në _____ dhe _____ në Jug.
Si kufi ndërmjet territoreve ku flitet _____ dhe atyre ku flitet toskërisht, merret lumi

Ajo gjuhë që kuptohet e përdoret nga të gjithë pjesëtarët e një kombi, quhet gjuhë [kombëtare](#).

Gjuha standarde dallohet për zbatim të _____ të rregullave në të folur e në _____. Gjuha standarde është gjuha që përdoret në shkollë, _____ etj.

2 Shkruani në gjuhën standarde fragmentin e mëposhtëm.

E në kasollë, e cila gjëmon nën barrën e borës, derdhen dy ngjyra, kuq e zi. I kuq zjarrmi i votrës në mes të kasolles, e i zi rrethi. Të zeza, t'errta janë skutat e kasolles nga ndëgjohet blegrim'e mekun e ndoj delje, ose kumbana e lopës. Edhe ata i vret bukuria e bardhë. Nga goja u del avulli i afsheve që ngrihen n'ajr, bjen mbi qimet e tyne si brymë dhe kristalizohet. Heshtje. Gjithshkafja e kristalizueme. Një dorë shtrihet, zen një dru, e shpupurish zjarrmin. Rropos një botë gacash. Flaka lëpin errsinën e shkëndijat kércejn nën tra dhe nëpër ftyra rreth votrës. E trupat e njerëzve dridhen, nëpër kurriz u pëershkohet të ftohit që vjen nga skutat, andej nga errsina. Brr... uf... andej mprapa shpinet përpijnë errsina me të ftoftit e saj.

- Po shiko, mos ngrin Laroja?

Dhe çohen, i lëshojnë vend rreth zjarrmit Larojës, lopës së shtëpis. Të nxehet edhe ky pjestar familje në kasollen e kristalizuem. E Laroja din si duhet m'u shtritmë rreth zjarrmit. Por, me trupin e saj të madh qati shtypi dy vocrrakë, të cilët i kish zanë gjumi prej zjarrmit.

"Bukuria që vret", Migjeni

Fjalët shqipe dhe fjalët e huaja

1 Plotësoni tabelën me fjalët e dhëna sipas llojit.

darkë, çel, djathë, dimërak, punëtor, mjekër, mot, shtegtar, zemërmirë, përmirësoj, çuçurit, mërmërit, gurgullon, zukat.

Fjalë të hershme të leksikut të shqipes	Fjalë të prejardhura dhe të përbëra	Fjalë të formuara nga pasthirrmat dhe onomatopetë

2 Plotësoni tabelën me fjalë të huazuara të shqipes sipas llojit.

Huazime për arsyet e ndryshme	Terma ndërkontekstuale	Me nuanca të reja kuptimore	Të pranuara në stilin e ndryshme	Terminologji fushash	Të ardhura së bashku me konceptin, mjetin

3 Zgjidhni fjalën e saktë të gjuhës shqipe.

adapt / i përshtatshëm; përvojë / eksperiencë; aprovoj / miratoj; eksigjent / kërkues; i shkëlqyeshëm / ekselfent; influencë / ndikim; injorancë / padituri; perfekt / i përkryer

4 Shkruani një listë me dhjetë terma të huazuar që përdoren rëndom nga të rinjtë dhe gjeni gjegjësen e tyre në gjuhën shqipe.

5 Shkruani emrat e disa emisioneve televizive, për të cilat janë përdorur fjalë të huazuar. Propononi t'i shkruani me fjalë të shqipes.

Top story.....

.....

Fjalë dhe forma gjuhësore që përdoren gjatë të folurit dhe që dëmtojnë gjuhën

- 1** Zëvendësoni fjalët e huaja me fjalë të gjuhës shqipe.

adapt _____

aprovoj _____

konkluzion _____

ambient _____

sahat _____

adaptim _____

avancoj _____

gratis _____

eksigjent _____

ekselent _____

eksperiencë _____

dynja _____

- 2** Formoni familje fjalësh nga fjalët e huaja, të cilat kanë hyrë në gjuhën shqipe si domosdoshmëri.

muzikë

respekt _____

firmë _____

mur _____

- 3** Shkruani një tekstu përshkrues, në të cilin të përdorni fjalë të huazuara nga fusha e teknologjisë së informacionit, si: kompjuter, internet, informatikë, *e-mail*, tablet etj.

Përemri pronor

1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.

Përemri që tregon përkatësi ndaj një vete të caktuar, quhet _____. Kemi përemra pronorë vetore: _____ etj., si dhe _____: i vet/e vet.

Përemrat pronorë kanë kategoritë e vetës, të _____, të numrit dhe të _____.

Përemrat pronorë mund të përdoren të shoqëruar me _____ ose në _____ të këtyre emrave.

Kur përemrat pronorë vendosen pas emrit, atëherë ky _____ përdoret në trajtë _____.

Kur përemrat pronorë vendosen para emrit, atëherë _____ është gjithmonë në trajtë _____.

Përemrat pronorë të vetës së parë dhe të vetës së dytë shumës *e mi*, _____, _____, _____ lakohen njësoj si _____.

Pronorët e vetës së parë shumës *tanë*, _____, _____, _____ lakohen ashtu si _____.

Përemrat pronorë të vetës së tretë *i (e) tij*, *i (e) saj*, *i (e) tyre*, *i (e) vet*, *e veta* lakohen njëloj si _____.

Të gjithë përemrat pronorë mund të _____ dhe të lakohen si emra mashkullorë ose _____.

2 Qarkoni trajtën e saktë të përemrit pronor.

- | | |
|--|--|
| <input type="checkbox"/> Atdheu jonë quhet Shqipëri. | <input type="checkbox"/> Atdheu ynë quhet Shqipëri. |
| <input type="checkbox"/> Motra juaj më tha. | <input type="checkbox"/> Motra tuaj më tha. |
| <input type="checkbox"/> Mësueses tënde i sollën lule. | <input type="checkbox"/> Mësueses sate i sollën lule. |
| <input type="checkbox"/> Ky është një i njohuri tim. | <input type="checkbox"/> Ky është një i njohuri im. |
| <input type="checkbox"/> Do të kesh mbështetje nga ana e jonë. | <input type="checkbox"/> Do të kesh mbështetje nga ana jonë. |

3 Plotësoni tabelën e lakimit të përemrit pronor.

libri im (v. III, njëjës) *vajzat e mia* (v. I, shumës) *djemtë e mi* (v. II, shumës)

E. _____	E. _____	E. _____
Gj. _____	Gj. _____	Gj. _____
Dh. _____	Dh. _____	Dh. _____
K. _____	K. _____	K. _____
Rrj. _____	Rrj. _____	Rrj. _____

4 Emërzoni përemrat pronorë dhe formoni fjali me ta.

yt/ _____
 jonë/ _____
 e saj/ _____
 tuaja _____
 e tij/
 tanë/ _____

Përemri vetvetor dhe përemri pyetës

1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.

Përemri vetvetor është përemri që tregon vetën, e cila përfaqëson njëkohësisht edhe atë mbi të cilin _____, edhe atë që _____.

Përemrat vetvetorë lakohen si emrat _____ në trajtën e shquar të numrit _____. Ata përdoren njësoj në të dyja _____.

Përemri pyetës përdoret për të pyetur pér _____ ose pér _____.

Përemra pyetës që kanë kategorinë gramatikore të _____, numrit, _____.

Përemra pyetës që kanë vetëm kategorinë gramatikore të _____.

Përemra pyetës që _____: ç', çfarë, se.

2 Qarkoni (**V**), nëse thënia është e vërtetë ose (**G**), nëse është e gabuar.

	V	G
▢ Përemri vetvetor është përemri që tregon vetën që përfaqëson atë mbi të cilin ushtrohet një veprim.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
▢ Përemrat vetvetorë janë: <i>vetja, vetvetja</i> .	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
▢ Përemrat pyetës janë: <i>kush, cili, çfarë, sa, i sati</i> etj.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
▢ Përemrat pyetës <i>cili</i> dhe <i>i sati</i> nuk kanë kategori gramatikore.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
▢ Përemrat pyetës: <i>kush</i> dhe <i>sa</i> kanë vetëm kategorinë gramatikore të rasës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
▢ Përemrat pyetës ç', çfarë, kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, të numrit dhe të rasës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

3 Pasi të lexoni fragmentin, shkruani jo më pak se 6 pyetje ku të përdorni përemra.

Rronte njëherë një lypës në fshat. Çdo ditë, ai merrte thesin e tij të vjetër dhe dilte pér të lypur. Një ditë, tekxa po ecte nëpër pyll, ai pa t'i shfaqej befas përpara një magjistare. Ajo i tha: – Unë jam magjistare dhe prej kohësh kam dashur të të ndihmoj. Ja, shiko këtu florinjtë që të kam sjellë. Lypësi u gëzua dhe rrëmbeu menjëherë thesin e vet të madh.

– Por hap sytë, – vazhdoi magjistarja. – Në rast se monedhat e arta do të shpojnë thesin dhe florinjtë do të bien përdhe, ato do të kthehen menjëherë në baltë.

Ai hapi me të shpejtë thesin dhe florinjtë nisën të bien në të. Kur u mbush gjysma e thesit magjistarja tha: – Kujdes se thesi t'u rëndua!

Pyetje:

Çfarë mbante pranë vetes magjistarja?

Folja në mënyrat kushtore dhe habitore

1 Nënvizoni foljet e mënyrës kushtore.

Po të kisha mësuar më shumë, do të kisha marrë notë më të mirë. Po të isha zgjuar më herët, ndoshta do ta kisha kapur autobusin. Po ta dija se kishit ardhur, do të kisha ardhur më herët. Do të vija me ty në plazh po qe se shkonim me makinën e re. Nëse e gjen në kohë, besoj se do të më lajmërosh.

2 Plotësoni tabelën me zgjedhimin e foljeve në kohët e mënyrës kushtore.

Folja/veta				
unë	do të haja			do të kisha larë
ti		do të kishe parë		
ai/ajo				
ne			do të festonim	
ju				
ata/ato				

3 Shkruani nga një fjali me folje në mënyrën kushtore për çdo kohë dhe tregoni kohën dhe vetën në të cilën i keni përdorur.

_____ (koha _____ veta _____)

4 Nënvizoni foljet e mënyrës habitore.

Unë qenqam një njeri i fortë. Askush nuk më paska njohur si të tillë. Kurrkush nuk paska marrë vesh se çfarë më ka ndodhur. Shumë paskam duruar. Qenkëshin dashur shumë ata të dy. Është hera e dytë që e zënqam veten në faj. Ai më tha se qenkëshim takuar në vjeshtë. Unë nuk e mbajtkam mend këtë gjë.

5 Plotësoni tabelën me zgjedhimin e foljeve në kohët e mënyrës habitore.

Folja/veta				
unë	qen kam			qen kam larë
ti		folkësha		
Ai/ajo				
ne		paskëshim lënë	paskam festuar	
Ju				
Ata/ato				

6 Plotësoni fjalinë me foljen e duhur.

Bora paska kohë që nuk _____ (folka/fliska) me Enin.

Ai nuk _____ (banoka/banuaka) shumë larg që këtu.

Mësuesi do t'i _____ (merrka/marrka) të gjithë me vete.

Ajo i _____ (sillka/sjellka) çdo vit fëmijët për pushime këtu.

Meri _____ (shkroka/shkruaka) shumë bukur.

7 Shkruani 4 fiali ku të përdorni foljet: *punoj, shkruaj, kap, shoh* në kohët e mënyrës habitore.

Koha e tashme: punoj

Koha e pakryer: kap

Koha e kryer: shkruaj

Koha e më se e kryer: shoh

Folja në mënyrat dëshirore dhe urdhërore

1 Nënvizoni foljet në mënyrën dëshirore dhe tregoni çfarë shprehin (urim, mallkim).

Ju ardhshim për të mira! (_____) U bëftë 100 vjeç djali! (_____) Paçi gëzime pafund! (_____)

E paç gojen e mbarë! (_____) Paska marrë me vete çdo gjë! (_____) Ju pastë lënë uratën! (_____) E gjetshi nga mos e pandehshi! (_____)

2 Zgjedhoni foljet e dhëna në mënyrën dëshirore.

unë	lënça			
ti				
ai/ajo	pastë kërkuar			
ne	gëzofshim			
ju	qofshi bekuar			
Ata /ato				

3 Shkruani foljet e dhëna në mënyrën urdhërore.

Folja	urdhërore veta II, njëjës	urdhërore veta II, shumës
godas		
mbështjell		
hap		
kërkoj		
pi		
shpalos		
fërkoj		

4 Shkruani fjali me folje në mënyrën urdhërore që shprehin:

urdhër: _____

këshillë: _____

porosi: _____

lutje: _____

kérkesë: _____

5 Shkruani në mënyrën dëshirore dhe urdhërore foljet:

djeg, djegsha, digj; rri,,, ; laj,,, ;

thaj,,, ; kap,,, ; jap,,, ;

dal,,, ; ndjek,,, ; fal,,, ;

6 Kthejini foljet e fjalive të mëposhtme nga folje të mënyrës urdhërore në folje të mënyrës dëshirore.

Përparoje o zot këtë vend!

Mbushua shtëpitë e oborret plot!

Shuaji armiqtë dhe keqbërësit!

Jepu begati dhe mirësi pafund!

Zgjedhimi jovepror në mënyrat: dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore dhe urdhërore

1 Plotësoni tabelën me zgjedhimin e foljeve në kohët e mënyrës kushtore.

<i>Folja/veta</i>				
<i>unë</i>	do të haja			do të kisha larë
<i>ti</i>		do të kiske parë		
<i>ai/ajo</i>				
<i>ne</i>			do të festonim	
<i>ju</i>				
<i>ata/ato</i>				

2 Shkruani nga një fjali me folje në mënyrën kushtore për çdo kohë dhe tregoni kohën dhe vetën në të cilën i keni përdorur.

_____ (koha _____ veta_____)
 _____ (koha _____ veta_____)
 _____ (koha _____ veta_____)
 _____ (koha _____ veta_____)

3 Plotësoni tabelën me zgjedhimin e foljeve në kohët e mënyrës habitore të formës joveprore.

<i>Folja/veta</i>		
<i>unë</i>		u krehkam
<i>ti</i>		
<i>Ai/ajo</i>		
<i>ne</i>	u veshkemi	
<i>Ju</i>		
<i>Ata/ato</i>		

4 Qarkoni **V** nëse thënia është e vërtetë dhe **G** nëse është e gabuar.

- | | V | G |
|--|--------------------------|--------------------------|
| <input checked="" type="checkbox"/> Format joveprore të foljeve ndërtohen me anë të foljes ndihmëse <i>jam</i> . | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input checked="" type="checkbox"/> Edhe format foljore të pashtjelluara (përveç pjesores) e ndërtojnë formën joveprore me anë të pjesëzës <i>u</i> . | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input checked="" type="checkbox"/> Në zgjedhimin jovepror, me anë të foljes ndihmëse <i>jam</i> NUK ndërtohen të gjitha format foljore të përbëra të së shkuarës. | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| <input checked="" type="checkbox"/> Format foljore të pashtjelluara mohore dhe përcjellore e formojnë formën joveprore me anë të foljes ndihmëse <i>jam</i> . | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

5 Në tekstin e mëposhtëm, nënvizoni format joveprore të foljeve dhe shpjegoni si janë ndërtuar.

Në pyllin pranë një fshati ishte mbjellë një lis kaq i madh, sa pesë vetë bashkë mezi e pushtonin.

Kur e pa sëpata e vogël këtë lis të madh e të gjatë, u habit shumë:

– O sa mirë! Me drurin e këtij lisi ndërtuakemi të gjitha shtëpitë e reja të fshatit, – tha ajo e gëzuar dhe u afrua te lisi për të nisur punën.

Lisi, i krekosur, ngriti zërin tërë mburrje e zemërim që ta dëgjonin të gjithë:

– Ti je e vogël sa një kleçkë e do të matesh me mua?! Shko matu me dëllinjën më mirë, – qeshi e qeshi me të madhe.

Qeshi lisi i madh dhe kanë qeshur edhe lisat e tjera. Sëpata e vogël u ul poshtë pemës, uli kokën dhe filloj të bjerë mbi trungun e trashë të lisit.

Tak-tuk sot e tak-tuk nesër. Ditët iknin e lisi i madh krekoj. Sëpata e vogël vazhdonte punën pa bërë fjalë. Pa u lodhur, puno natë e ditë e lisi prapë nuk dorëzohej, qëndronte hijerëndë.

6 Plotësoni tabelën e mëposhtme me format joveprore të foljeve në mënyrën dëftore.

Folja	Forma joveprore Mënyra dëftore			Eardhme
	E tashme	E pakryer	E kryer e thjeshtë	
ul				
lexoj				
shqetësoj				

7 Plotësoni tabelën e mëposhtme me format joveprore të foljeve në mënyrën lidhore.

Folja	Forma joveprore Mënyra lidhore			Eardhme
	E tashme	E pakryer	Eardhme	
ul				
lexoj				
shqetësoj				

8 Plotësoni tabelën e mëposhtme me format joveprore të foljeve në mënyrën kushtore.

Folja	Forma joveprore Mënyra kushtore		
	E tashme	E pakryer	E ardhme
ul			
lexoj			
shqetësoj			

9 Plotësoni tabelën me format joveprore të foljeve në kohët e përbëra të së shkuarës dhe së ardhmes, në vetën e parë, numri njëjës.)

	e kryer	më se e kryer	e kryer e tejshkuar	e ardhme e përparme
mënyra dëftore		isha mësuar		
mënyra lidhore	të jem mësuar			
mënyra habitore				
mënyra kushtore				
mënyra dëshirore				

10 Zgjedhoni foljet në formën joveprore sipas mënyrës, kohës dhe vetës.

	Mënyra dëftore						
	Koha e tashme	Koha e pakryer	Koha e kryer e thjeshtë	Koha e kryer	Koha më se e kryer	Koha e kryer e tejshkuar	Koha e ardhme e përparme
Unë	gëzo-hem	gëzo-hesha	u gëzova	jam gëzuar	isha gëzuar	qeshë gëzuar	do të jem gëzuar
Ti							
Ai/Ajo							
Ne							
Ju							
Ata/Ato							

	Mënyra lidhore				Mënyra habitore			
	Koha e tashme	Koha e pakryer	Koha e kryer	Koha më se e kryer	Koha e tashme	Koha e pakryer	Koha e kryer	Koha më se e kryer
Unë	të vishem	të vishesha	të jem veshur	të isha veshur	u veshkam	u veshkësha	qenkam veshur	qenkësha veshur
Ti								
Ai/Ajo								
Ne								
Ju								
Ata/ ato								

	Mënyra dëshirore		Mënyra kushtore	
	Koha e tashme	Koha e kryer	Koha e tashme	Koha e kryer
Unë	u bëfsha	qofsha bërë	do të bëhesha	do të isha bërë
Ti				
Ai/Ajo				
Ne				
Ju				
Ata/Ato				

	Mënyra urdhërore Koha e tashme
Ti	bëhu
Ju	

Pasthirrma

- 1 Qarkoni (**V**), nëse thënia është e vërtetë ose (**G**), nëse është e gabuar.

V **G**

Pasthirrma është pjesë e ndryshueshme e ligjëratisë që shërben për të shprehur ndjenjën a vullnetin e folësit.
 Pasthirrma shërben edhe për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit.
 Pasthirrma mund të jetë një tingull ose grup tinguish, një fjalë apo grup fjalësh.
 Pasthirrmat shprehin gjëzim, admirim, kënaqësi.
 Pasthirrmat shprehin habi.
 Pasthirrmat nuk shprehin frikë, dëshpërim, hidhërim.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- 2 Plotësoni tabelën me pasthirrma sipas llojit.

a) Pasthirrma emocionale

Shprehin	Shembuj
gjëzim, admirim, kënaqësi	
habi	
frikë, dëshpërim, hidhërim	
mosbesim, mospërfillje, përbuzje	
pakënaqësi, keqardhje, mërzi	

b) Pasthirrma nxitëse

Shprehin	Shembuj
thirrje	
nxitje, urdhër, lutje	
përvendetje	
mirënjojje, mallkim, sharje, ngushëllim	

- 3 Shkruani 10 raste pasthirrmash në formën e onomatopeeve.
-
-
-

- 4 Shkruani fjali me pasthirrmat e mëposhtme.

Oho _____
 Urra _____
 Të lumtë _____
 Ua _____
 Bobo _____

- 5 Lexoni fragmentin dhe dalloni pasthirrmat e llojin e tyre.

- Mirë, mirë. Dil e luaj, por mos u vono!
- Ohoho, sa bukur qenka këtu! Të lumtë, mami!
- Prit pak, ç'e ke atë xhep të fryrë?
- Bobo, ngriva. Aty kisha pakon me fishekzjarrë.
- Të lumtë! Urra!

Pjesëza

- 1** Qarkoni (**V**), nëse thënia është e vërtetë ose (**G**), nëse është e gabuar.

V **G**

Pjesëza shërben për të shprehur ngjyrime kuptimore, emocionale
ose plotësuese të një fjale.

Pjesëzat grupohen në pjesëza që shprehin ngjyrime
kuptimore, modale, emocionale.

Pjesëzat që shprehin ngjyrime kuptimore janë të thjeshta,
të përgjitura, shprehje.

Pjesëzat modale ndahen në mohuese dhe pohuese, pyetëse, dyshuese, zbutëse.

Pjesëzat për nga mënyra e formimit janë dëftuese, përcaktuese,
përforcuese, përafruese.

- 2** Plotësoni tabelën me shembuj.

a. Pjesëza që shprehin ngjyrime kuptimore të përgjithshme

dëftuese	
përcaktuese saktësuese	
përforcuese	
përafruese	

b. Pjesëza modale

pohuese	
mohuese	
pyetëse	
dyshuese	
zbutëse	

c. Pjesëza emocionuese shprehëse

emocionuese shprehëse	
-----------------------	--

- 3** Gjeni pjesëzat në fragmentin e mëposhtëm dhe tregoni llojin e secilës.

Ja se ç'thotë kjo gojëdhënë... Muri që e bënin ditën, prishej natën dhe kështu nuk e lartolin dot. Na shkon aty një plak i mirë. – Na thuaj, pra, ç'të bëjmë që ta qëndrojmë këtë kështjellë.

- 4** Shkruani 6 fjali duke përdorur pjesëza të llojeve të ndryshme.

Ndërtimi i fjalitës dhe analiza gramatikore e saj

1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.

Fjalia është njësia sintaksore themelore e kumtimit ligjërimor, që shprehet me një a _____ të lidhura gramatisht e të shqiptuara me intonacion _____.

Që fjalia të jetë e saktë, duhen përbushur dy kriterë të rëndësishme: ana _____ dhe ajo _____.

Fjalia nuk është një shumë e dosidoshme _____. Këto të fundit, duhet të lidhen së pari _____ sipas rregullave dhe ligjeve të gjuhës e më pas grupet _____ nën një fjali. Nuk mund të kemi fjali, kur fjalët _____ njëra-tjetërën pa një _____ të caktuar.

2 Nënvizoni fjalitë që janë të sakta nga ana gramatikore, por jo kuptimore.

Mësuesja nga këshilloi të bënim kujdes.

Nxënësit e gjetën ujin në shtëpi.

Pemëve vjeshtake u kishin rënë gjethet.

Malet i takoj shpesh.

Ne bëjmë gjithnjë një ekskursion në pranverë.

3 Nënvizoni fjalitë që janë të sakta nga ana kuptimore, por jo gramatikore. Rishkruajini saktë ato.

Pse nuk më njoftove më parë?

Pyes vehten se si do të arrijë rezultare kaq të mira pa ndimën tënde.

Si është parashikimi i motit përvjetor e ardhshme?

Shtohet pyetja se kush do ta marë pësipër këtë punë.

4 Rishkruani fjalitë e mëposhtme, duke ndryshuar rendin e fjalëve.

Pothuajse të gjitha vajzat, kur udhëtojnë, marrin me vete valixhe të rënda.

Me të zbardhur dita, dolëm në rrugë.

Djali që takuam dje, do të vijë në klasën tonë.

Funksionet gramatikore të fjalëve në fjali

1 Bëni analizën e gjymtyrëve në fjalinë e mëposhtme.

Sot më janë hapur sytë. Sikurtë mos kisha ruajtur qetësinë e brendshme shpirtërore, nuk do të kisha shpëtuar kurrë. Ndoshta asaj duhet t'i jem falë që u bëra ky që jam sot, qetësisë që më pushtoi si kaluan ato ditët e para në anije. Por atë qetësi unë ua detyroj në radhë të parë njerëzve të anijes.

2 Në tekstin e mësipërm, dalloni fjalët drejtuese dhe fjalët e varura. Mbani parasysh që një fjalë mund t'i kryejë të dyja rolet. Plotësoni tabelën.

Fjalë drejtuese	Fjalë e varur

3 Qarkoni (**V**), nëse thënia është e vërtetë ose (**G**), nëse është e gabuar.

V **G**

Fjalët luajnë rol drejtues kur u caktojnë fjalëve të tjera formën e shprehjes
dhe rolin e tyre në fjali.

Mbiemri del gjithnjë si fjalë e varur.

Vetëm fjalët që ndodhen pranë njëra-tjetrës hyjnë në lidhje sintaksore.

Mes kryefjalës dhe kallëzuesit duhet të ketë përshtatje në vetë dhe në numër.

Fjala e varur duhet të qëndrojë gjithnjë pranë fjalës drejtuese.

4 Për çdo thënie të gabuar, sillni nga një shembull që dëshmon të kundërtën.

5 Në fjalitë e mëposhtme, dalloni dhe përcaktoni funksionin e foljeve të pashtjelluara. Thoni nëse dalin si fjalë drejtuese apo të varura.

Për të mësuar një gjuhë të huaj, duhet shumë vullnet.

Vullneti për të mësuar e lehtëson mjaft barrën e të nxenit.

Nuk flitet mirë një gjuhë e huaj, pa u mësuar si duhet gramatika e saj.

I vogli e përdor gjuhën e nënës pa i njohur rregullat e gramatikës.

Njeriu, duke u rritur, i humbet disa aftësi për mësimin e gjuhëve.

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe ato me nënrenditje

- 1** Dalloni fjalitë e përbëra me bashkërenditje nga fjalitë e thjeshta. Argumentoni përgjigjen tuaj.

Drita e mëngjesit mezi futej nëpër frëngjité e ngushta dhe në të çarat e mureve. Aty nga ora shtatë filloj përsëri një lëvizje e paprerë nëpër galeritë, në vendkalimet, në hyrjet dhe në daljet e kështjellës. Gjithmonë e më tepër njerëzit takonin dhe përshëndesnin të njohurit e tyre. Babazoti ishte ulur në shezlongun e tij dhe lexonte një libër.

- 2** Nënizoni pjesët e fjalive që bashkërenditen mes tyre. Dalloni lidhëzat përkatëse.

Shkova në park dhe lexova librin që më dhurove dje. Do të ishte mirë ta lije makinën në shtëpi dhe të përdorje më tepër mjetet e transportit publik. Shkova për pushime, por nuk e gjeta rehatinë që kërkoja. Do të flas me të dhe do t'i them të kthejë rrugë sa s'është vonë.

- 3** Plotësoni pjesët e fjalive të dhëna me pjesë të bashkërenditura. (Kujdes pikësimin.)

- a) ose do të heq dorë.
- b) apo më bëjnë sytë.
- c) kurse netëve nuk pipëtinte asgjë.
- d) por askush nuk foli.
- e) dhe frynte një fillad i lehtë.

- 4** Dalloni rastet kur lidhëzat lidhin gjymtyrë fjalie ose pjesë fjalish dhe plotësoni tabelën e mëposhtme.

Nuk fola as unë, as Bardha. As diell nuk kishte, as shi nuk binte. Do të nisemi të hënën dhe do të kthehemë të premten. Të shtunën dhe të dielen jemi këndeje. Kush fitoi, ti apo ajo? Të nisemi apo të rrimë këtu? Erdhëm për të vizituar qytetin dhe për të marrë pjesë në festivalin e këngës. Jo vetëm ne, por as ata nuk ishin nisur. Jo vetëm që nuk erdhën, por as na njoftuan për këtë.

Gjymtyrë fjalie	Pjesë fjalish

- 5** Shkruani përbajtjen e shkurtuar të një tregimi, duke përdorur fjali të përbëra me bashkërenditje. Nënizoni lidhëzat.
-
-

6 Ndryshoni rendin e pjesëve të bashkërenditura, aty ku është e mundur.

Unë po studioj gjuhën frëngje, ndërsa vëllai im po mëson gjermanishten. Mësuesja hyri në klasë, por pëshpërimat e nxënësve s'kishin të ndalur. Vajza e mori letrën dhe e futi në çantë. Ose do të nisemi të gjithë, ose nuk do të shkojë asnjëri prej nesh. Jo vetëm që na lagu shiu, por na griu edhe një erë e ftohtë veriu.

7 Dalloni fjalitë e thjeshta nga ato të përbëra. Argumentoni përgjigjen tuaj.

Mbetëm në mes të rrugës, sepse u prish makina. Nuk ecej më tej për shkak të rrëshqitjes së dheut. Ecnim nga të na çonin këmbët. Ecnim si të dehur pa e ndalur vrapin. Po të na shihte njeri, do të queshte me ne. Kushdo do të queshte me pamjen tonë. Duhet ta lësh duhanin që të mbrosh shëndetin tënd. Erdhi e u shëndosh së tepërmë pas lënies së stërvitjes. Nuk mund të veprojmë gjithnjë sipas kokës sonë.

8 Dalloni fjalitë e nënrenditura dhe nënvizoni lidhëzat përkatëse.

U bë siç tha ai. Ngrije zërin, të lutem, se nuk dëgjohesh! Libri që lexova, më pëlqeu shumë. U bë gjithçka që ura të ndërtohej. Kur u pastrua pista, të gjithë iu rikthyen skive. Ngado të hidhje sytë, s'shihje një pemë të mbjellë. Dolëm, ndonëse vazhdonte të binte shi. Nëse e shkuara harrohet, rrezikon të përsëritet prapë. U ngrit të dilte.

9 Zëvendësoni rrethanorët me fjali të varura nënrenditëse.

Shembull: Duart i dridheshin nga të ftohtët. Duart i dridheshin, sepse bënte ftohtë.

a) Shkoi në bibliotekë për të marrë një libër.

b) Rrini si në shtëpinë tuaj.

c) Dolëm, pavarësisht shiut të rrëmbyer.

ç) Nga e nesërmja e tutje do të punoj më shumë.

d) Ai do të jetonte mirë në çolloj vendi.

dh) Pa ndihmën tuaj, nuk bëhej kjo punë.

e) Qeshëm me lot në sy.

10 Përcaktoni llojin e fjalive rrethanore të ushtrimit 9.

- a) Pjesë e varur _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____
- e) _____
- f) _____
- g) _____

11 Për secilin çift fjalish, dalloni llojin e pjesës së nënrenditur dhe lidhëzat.

1. a) Sapo ra zilja, fëmijët brofën nga vendi.
b) Fëmijët brofën nga vendi, meqë ra zilja.
- a) _____
b) _____
2. a) Nëse bie borë, mund të shkojmë në mal.
b) Ndonëse bie borë, mund të shkojmë në mal.
- a) _____
b) _____
3. a) Ëndërronte të bëhej pianist i zoti.
b) Ëndërronte siç dinë të ëndërrojnë vetëm fëmijët.
- a) _____
b) _____
4. a) U gëzua aq sa s'pushonte më së foluri.
b) U gëzua, sado që të tjerët s'pushonin së foluri.
- a) _____
b) _____

Fjalitë e përbëra me bashkërenditje, llojet e tyre

1 Plotësoni fjalitë me fjalën/fjalët e duhura.

Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje janë _____ prej njëra-tjetrës. Ato lidhen mes tyre me _____ bashkërenditëse ose pa _____.

_____ e këtyre fjalive mund të qëndrojnë edhe si _____ më vete:

Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje shtuese lidhen me
_____ : *e, dhe, jo vetëm...por edhe, as....as* etj.

Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje kundërshtuese lidhen me _____
_____ : *po, por, mirëpo, kurse, veçse* etj.

Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje veçuese lidhen me
_____ : *ose, o, apo, ose....ose, o....o* etj.

Pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje përmbyllëse lidhen me
_____ : *prandaj, ndaj, pra* etj.

2 Dalloni fjalitë me bashkërenditje. Tregoni mjetet e lidhjes.

Kam humbur midis një stuhie bore, era fishkëllen dhe hedh shtresa dëbore në sytë e mi. Thërras pér ndihmë, por era m'i mbyt të qarat. Rrëzohem mbi dëborë dhe mezi marr frymë, mirëpo era rënkon në veshët e mi. Shoh si era mbulon gjurmët e mia. Tani jam veç një fantazmë, qaj përsëri, por shpresa po zhduket, ndaj përpinqem të ngrihem. Përtej perdeve të dëborës, më zë syri diçka që lëviz, një mori ngjyrash.

3 Lidhni fjalitë e mëposhtme me lidhëza bashkërenditëse. Përcaktoni llojin e tyre.

a) Këtë fundjavë kam dëshirë të takoj prindërit e mi. Do të jem në punë sërisht.

b) Ishte dimër. Një shi i rrëmbyer dukej sikur do të shpërthente egërsisht.

c) Do të shkojmë në Theth. Do të shkojmë në Vlorë.

ç) Tashmë jam 18 vjeç. Pres të më blesh makinën.

d) Foli gjatë pér arritjet e tij. Nuk tha asgjë të re.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje fìlluese: kryefjalore, kundrinore

- 1** Lidhni foljet me variantet e dhëna në të djathtë të tyre. Analizoni fjalitë e përfshira.

Porositi	për të lënë një dëshmi të pakundërshtueshme shumë vargje
Na tha	një kafe fjalën e fundit të parën këtë të gjithë të afërmit e tij që puna mund të shkonte deri aty
Nuk e imagjinoja	ç'i erdhi në mendje më shumë se ç'konsumoi ç'ndieja të vërtetën
Shkrova	një fund të tillë

- 2** Shpjegoni përsë janë të papranueshme fjalitë e mëposhtme. Rishkruijini si duhet.

Gjithçka e dija se kush kishte ardhur. _____

Ai mendonte ai të nisej nesër. _____

Punën e filluan të ndërtojnë teatrin. _____

Diçka dukej se do të binte shi. _____

- 3** Ktheni fjalitë pyetëse në pjesë të varura fìlluese kundrinore dhe kryefjalore të një fjalie të përbëre.

Si shkohet atje?

Kundrinore _____

Kryefjalore _____

Sa është ora?

Kundrinore _____

Kryefjalore _____

Kush foli?

Kundrinore _____

Kryefjalore _____

- 4** Dalloni pjesët e varura fìlluese dhe përcaktoni llojin e tyre.

Ai rrudhi fytyrën. Më tha se përgjigjet e mia ishin gjithnjë të tèrthorta, se nuk kisha asnjë pikë ambicieje dhe se mungesa e saj ishte shkatërruese për një njeri që merrej me tregti. Atëherë u ktheva në zyrë dhe u ula të punoja. Do të më kishte pëlqyer të mos e mërzisja pronarin, por nuk shihja asnjë arsyë për të ndryshuar jetën time. Kur isha student, kisha shumë ambicie, por, kur m'u desh të braktisja studimet, e kuptova se e gjitha kjo nuk kishte pikë rëndësie.

- 5 A mund t'u shtojmë fjalive të mëposhtme një pjesë të nënrenditur ftilloese? A mund të kthehen këto fjali në pjesë të nënrenditura ftilloese? Argumentoni përgjigjen tuaj.

 Ai fle shumë.

 Më pihet ujë.

 Pse nuk erdhe me ne?

 Kush foli?

 E thashë pa u menduar gjatë.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: kohore, vendore

- 1** Përcaktoni funksionin që kryen pjesa e varur "kur trokitën në derë" në lidhje me pjesën drejtuese.

Kur trokitën në derë, doli nëna t'i priste.

Nuk e mbaj mend kur trokitën në derë.

Nuk dihej kur trokitën në derë.

Nuk dihej ora kur trokitën në derë.

- 2** Formoni katër fjalë të përbëra, në të cilat, pjesa e varur "ku derdhet Vjosë" të kryejë funksionet e përmendura më sipër.
-
-
-
-

- 3** Ktheni rrethanorët e kohës në pjesë të varura rrethanore kohore.

Treni u boshatis me të mbërritur në stacion.

Me të rënë nata, xixëllonjat ia behnin anës rrugës.

Me fillimin e shirave, trafiku rëndohej më keq.

Mbrëmjeve, mblidheshin e këndonin deri vonë.

- 4** Zëvendësoni pjesët e varura vendore me rrethanorë vendi.

U takuan ku e kishin lënë.

Sytë i mbante të ngulitur tek ishte një hartë e vjetër.

E ktheu kokën nga erdhi zëri.

Po ngrihej një godinë aty ku kishte qenë dikur një kishë e vjetër.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: shkakore, qëllimore

- 1** Dalloni nëse fjalia është me pjesë të nënrenditur shkakore apo qëllimore. Shënoni me ✓.

	Sh	Q
Mori rrugën e vjetër që t'i shmangej trafikut.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mori rrugën e vjetër, ngaqë andej kishte më pak trafik.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Ajo, nga frika se mos binte, kapej fort pas krahut të tij.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Që të mos binte, ajo kapej fort pas krahut të tij.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Meqë donte të studionte jashtë vendit, u kushtonte shumë kohë gjuhëve të huaja.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Që të studionte jashtë vendit, duhej t'u kushtonte shumë kohë gjuhëve të huaja.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- 2** Ndërtoni fjalë shkakore duke përdorur lidhëzat:

ngaqë _____

se/sepsë _____

meqë _____

meqenëse _____

duke qenë se _____

nga frika se _____

- 3** Zëvendësoni rrethanorët e qëllimit me pjesë të varura qëllimore.

Dilte majë kodrës për të shijuar më mirë zhurmat e mbrëmjes.

Pleqësia mblidhej për të gjykuar mosmarrëveshjet mes banorëve.

Për të mos i prishur qejfin, askush nuk e kundërshtoi.

Vuri dorën në ballë, për t'u mbrojtur nga dielli i fortë.

- 4** Dalloni marrëdhëniet rrethanore shkakore dhe qëllimore dhe thoni në janë shprehur me gjymtyrë apo me pjesë fjalie. Nënvizoni fjalët dhe pjesët drejtuese për secilin rast.

Shtanga nga habia. U përkula drejt një xhandari dhe e pyeta përse fliste në atë mënyrë avokati.
 – Kështu bëjnë të gjithë avokatët, – ma ktheu ftohtë. – Habitem, zotërinj, – shtoi ai, – që u bë tërë ajo zhurmë rreth azilit, sepsë, në fund të fund, ata s'janë veçse një provë për dobinë e këtyre institucioneve. Mjafton të thuash se është vetë shteti që i mban. Për shkak të gjithë atyre fjalive të gjata, të gjithë atyre ditëve dhe atyre orëve pambarim, pata përshtypjen se çdo gjë po bëhej si një ujë i pangjyrë ku më merreshin mendtë.

- 5** Shkruani një tekst shpjegues-informues duke përdorur fjali të përbëra me pjesë të nënrenditura shkakore dhe qëllimore. Nënvizoni lidhëzat dhe pjesët drejtuese të fjalive.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: mënyrore, rrjedhimore

- 1** Dalloni nëse fjalia është me pjesë të nënrenditur rrjedhimore apo qëllimore. Shënoni me ✓.

Duhej të ishe naiv që të mos e kuptoje kaq gjë.
 Mbajti hapin që të dëgjonte më mirë.
 Mos më ndërprit që të mos ia rifilloj nga e para.
 Nuk ka bërë ndonjë faj që ta dënojmë.
 Nuk ke tagër që ta kërkosh këtë.
 Njeriu duhet t'i njohë të drejtat e veta, që të mund t'i kërkojë ato.

Rr	Q
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- 2** Në poezinë e dhënë, dalloni rrethanorët e mënyrës dhe pjesët e varura mënyrore. Plotësoni tabelën.

Më falni diçka që më kënaq si puthja e nanës në ballë, më gëzoni nji herë si gëzohet gjethi i njomë në puhi, më shikoni si hana nëpër rrema e kam me u falë gjithçka: mordjen do të puthi ndër buzët e ngrime dhe në zgavrat e synit të saj do të derdhi lot. Avitu njeri! Nga palci i urrejtjes dëshiroj me dalë si bima prej fare në pranverë. <i>(Martin Camaj)</i>	Rrethanorë mënyre	Pjesë e varur mënyrore

- 3** Formoni fjalë të përbëra me pjesë të varura mënyrore duke përdorur lidhëzat:
 si/sic; ashtu si/sic; kështu si/sic; sikur; sikurse; sikundër.
- 4** Formoni fjalë të përbëra me pjesë të varura rrjedhimore duke përdorur lidhëzat:
 sa; sa që; aq sa; që; kështu që; prandaj/ndaj.
- 5** Gjeni dhe nënvizoni rrethanorët e mënyrës dhe fjalitë e varura mënyrore dhe rrjedhimore, si dhe fjalët apo pjesët e tyre drejtuese.

Ata rrëshqitën në heshtje nën dritën verbuese. Gjithsej bëheshin nja dhjetë veta. U ulën me aq kujdes sa nuk kërciti asnë karrige. I shihja si nuk kisha parë kurrë më parë njeri aq sa nuk më shpëtonte asnë hollësi e fytyrës së tyre. Nuk ua dëgjoja zërin, ndaj e kisha të vështirë të besoja se ndodheshin aty, pranë meje. Pothuaj të gjitha gratë mbanin përparëse që i shtrëngonin aq shumë, sa u nxirrte më në pah barkun e tyre. Ndërsa burrat ishin pothuaj të gjithë thatanikë dhe mbanin në dorë nga një shkop.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: kushtore, lejore

- 1 Qarkoni (**V**), nëse thënia është e vërtetë ose (**G**), nëse është e gabuar.

V **G**

Veprimet apo gjendjet që shprehen në pjesët e fjalive kushtore kushtëzojnë njëri-tjetrin.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Koha e foljeve në fjalitë kushtore, përcakton mundësinë e kryerjes së veprimit.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Pjesa e varur kushtore qëndron gjithnjë pas pjesës drejtuese.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Pjesa e varur lejore nuk ndahet me presje nga pjesa drejtuese.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Pjesa e varur lejore ka rend të lirë në fjali.

- 2 Në cilat fiali është kryer veprimi dhe në cilat jo? Shënoni me ✓.

Po të vazhdojë më tej ngrohja globale, jeta e tokësorëve është në rrezik.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Po të ricikloheshin të gjitha mbetjet, ambienti do të ishte më i jetueshëm.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Gjërat do të shkonin më mirë po t'i njihnin njerëzit të drejtat
dhe detyrimet e veta.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Pushteti është gjithnjë i rrezikuar nëse thellohet padrejtësia sociale.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Nëse ligji nuk zbatohet njësoj për të gjithë, kushtetuta s'është
veçse një shkresurinë pa vlerë.

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- 3 Ktheni fjalitë e mësipërme në fiali me pjesë të varura lejore dhe analizoni formën dhe kuptimin e ri që përftojnë ato.

Shembull: Ndonëse ngrohja globale po vazhdon të rritet, jeta e tokësorëve nuk është në rrezik.

Pra, ndryshon gjithë kuptimi i fjalisë, ashtu si dhe forma e saj.

- 4 Përcaktoni llojin e fjalive të mëposhtme dhe funksionin e fjalës "kur".

E ke vendosur kur do të nisesh?

Kur të nisesh, më njofto.

Kur ikën macja, lozin minjtë.

Nuk dihet kur ndodhi e gjithë kjo.

- 5 Ndërtoni një tekst argumentues duke përdorur fiali me pjesë të varura kushtore dhe lejore. Vini në përdorim këto lidhëza: *në, nëse, në qoftë se, po, po qe se, me kusht që, kur, megjithëse, sado, sido që, kudo, kushdo* etj.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje, rrethanore: krahasore

- 1** Përcaktoni mjetet gjuhësore me të cilat realizohet krahasimi në fjalitë e dhëna.

Sa më shumë i flisje, aq më pak bindej.
 Sa ç'ishte i tërhequr ai, po aq ishte e paparashikueshme ajo.
 Erdhën më shpejt nga ç'i prisnim.
 U mërzit sa s'thuhet.
 Mësa fle lumi, aq fle hasmi.

- 2** Ndërtoni pesë fjali me pjesë të varura krahasore. Nënvízoni lidhëzat.

- 3** Dalloni nëse fjalia është me pjesë të nënrenditur krahasore apo rrjedhimore. Shënoni me ✓.

Zhurma ishte aq e lartë, sa nuk përqendrosheshe dot.
 Pema ishte aq e lartë, sa ç'ishte e lartë shtëpia.
 Sa më shumë i afroheshin përroit, aq më shumë dëgjohej kori e bretkosave.
 E teprove sa s'mban më.
 Shumë gjëra kushtojnë më shumë nga ç'vlejnë.

K	R
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- 4** Hartoni një tekst dramatik, ku të përdorni dendur fjali krahasore. Rishkruajini ato duke këmbyer, ku është e mundur, rolin e pjesëve të tyre. Analizoni formën dhe kuptimin e të dyja varianteve.

Fjalitë e përbëra me nënrenditje, përcaktore

- 1** Dalloni fjalitë përcaktore nga ato ftilluese. Shënoni me ✓.

Pashë librat që ishin në vitrinë.
 Pashë që librat ishin në vitrinë.
 Puna që bëhet mirë s'ka nevojë për reklamë.
 Them që puna e bërë mirë s'ka nevojë për reklamë.

P	F
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- 2** Qarkoni (**V**), nëse thënia është e vërtetë ose (**G**), nëse është e gabuar..

Pjesa e varur përcaktore hyn në lidhje me kallëzuesin e pjesës kryesore.
 Si mjete lidhëse, përfjalitë përcaktore, shërbijnë përemrat lidhorë që, i cili.
 Përemrat lidhorë i cili/e cila mund të shoqërohen me parafjalë.
 Pjesa e varur përcaktore mund të vendoset para pjesës kryesore.
 Të gjitha fjalitë përcaktore ndahen me presje nga pjesa kryesore.

V	G
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

- 3** Përcaktoni llojin e fjalive të mëposhtme dhe analizoni funksionin e fjalës "që".

Dihet që të ushqyerit ndikon drejtpërsëdrejti në shëndetin e njeriut.
 Që të jetosh shëndetshëm, duhet të bësh jetë aktive.
 Jo kudo që ka borë mund të bësh ski.
 Sporti që ndiqet më me interes, është futbolli.
 Është përf t'u habitur që futbollistët kanë të ardhura marramendëse.
 Që të fitosh një garë, nuk mjafton vetëm forca fizike.

- 4** Ndërtoni fjalit përcaktore duke përdorur këto mjete lidhëse:

të cilin

së cilës

prej të cilit

pa të cilën

që

- 5** Hartoni një tekstu rrëfimtar joletar në të cilin të përdorni të gjitha llojet e fjalive të nënrenditura. Nën vizoni mjetet lidhëse dhe pjesët drejtuese të fjalive.

Përdorimi i presjes në fjali

Në tekstin e mëposhtëm nuk janë zbatuar rregullat e pikësimit të fjalive të llojeve të ndryshme. Vendosni presjet në vendin e duhur.

Shtatë sorrat

Një burrë kishte shtatë fëmijë të gjithë djem dhe asnjë vajzë me gjithë dëshirën e madhe që kishte. Më në fund e shoqja i dha lajmin që po priste një fëmijë e kur doli në dritë ishte vajzë. Ishte e vogël dhe shumë e dobët. Nga frika se mos vdiste prindërit vendosën ta pagëzonin sa më parë.

Babai zgjodhi njërin nga djemtë të merrte ujin e bekuar për të bërë pagëzimin. Të gjashtë vëllezërit e tjerë shkuan me të dhe të gjithë donin të ishin të parët për të marrë ujin, por kana ra në pus. Po rrin në gjithë aty dhe asnjëri nuk dinte çfarë të bënte nuk guxonin të ktheheshin në shtëpi. Kur pa që nuk po ktheheshin babai tha: "Do të kenë humbur mbas ndonjë loje këta djem". Në pritje pasi fëmija mund të vdiste pa u pagëzuar duke u lutur ulériu: "U kthefshin të gjithë në sorra!" Sapo mbaroi së thëni këto fjalë u dëgjua zhurmë krahësh që përplaseshin sipër kokës së tij. Ngriti kokën dhe pa që ikën në fluturim shtatë sorra të zeza si qymyri.

Prindërit nuk mund ta tërhiqnin mallkimin me gjithë dhimbjen e madhe për humbjen e shtatë djemve. Ata gjetën mbështetje te vajza e vogël që shumë shpejt filloi të përmirësohej dhe çdo ditë bëhej më e bukur.

Për shumë kohë vajza nuk e dinte që kishte shtatë vëllezë. Prindërit e shikonin dhe donin t'i thoshin por nuk guxonin. Një ditë dikush i tha vajzës se ishte me të vërtetë e bukur por u bë sebep për shndërrimin e shtatë vëllezërve në sorra.

E trishtuar shkoi tek i ati dhe tek e ëma dhe i pyeti nëse ka pasur vëllezë dhe ku ndodheshin ata. Atëherë prindërit nuk mund ta mbanin më sekretin. E shkreta iku e dëshpëruar për humbjen e vëllezërve por nuk ishte faj i saj. Ditë për ditë vajza mendonte për këtë gabim dhe që duhej të bënte diçka për të gjetur vëllezërit e saj.

Nuk gjente më qetësi derisa një ditë iku fshehurazi nëpër botë për të kërkuar vëllezërit. Dëshironë t'i lironë në çfarëdolloj mënyre. Mori me vete një unazë të prindërvë që ta kishte me vete si kujtim një çikë bukë që të shuanë urinë një brokë të vogël me ujë për të shuar etjen dhe një karrige të vogël që të ulej kur të ishte e lodhur. Ec e ec dhe më në fund arriti në fund të botës. Arriti edhe në fund të diellit por ishte shumë nxehë dhe nuk ishte e mundur të qëndroje. Atëherë iku me vrap dhe qëndroi sipër Hënës por aty ishte shumë ftohtë dhe nuk ishte e mundur të rrinte.

Vajza iku edhe që aty e arriti tek yjet që ishin të mirë dhe të dashur. Çdonjëri prej tyre rrinte i ulur në karrigen e tij. Ylli i Mirë u çua dhe i dha një kockëz duke i thënë: "Pa këtë kockëz nuk mund të hapësh derën e maleve prej akulli ku janë mbyllur vëllezërit e tu". Vajza mori kockëzën e vuri në një shami dhe ndoqi rrugën deri në fund të maleve me akull.

Dera ishte e mbyllur e kur vajza kërroi të merrte kockëzën që kishte mbështjellë me shami nuk e gjeti aty nuk kishte më asgjë. Kishte humbur dhuratën që i kishte dhënë Ylli i Mirë. Çfarë të bënte? Donte të shpëtonte vëllezërit e saj por nuk kishte çelësin e maleve. Atëherë Ylli i Mirë mori thikën preu gishtin e vogël e futi në derë dhe ajo u hap. Sa hyri brenda vajza i doli përpara një xhuxh dhe e pyeti:

- Vajza ime çfarë kërkon?
- Kërkoj vëllezërit e mi shtatë sorrat – iu përgjigj.

Zotëria xhuxhi i tha që shtatë sorrat nuk ishin në shtëpi por nëse ajo do t'i priste pak kohë mund të hynte brenda.

Pastaj xhuxhi solli ushqimin për shtatë sorrat në shtatë pjata të vogla dhe shtatë tasa me ujë. Nga çdo pjatë motra mori një çikë ushqim për të ngrënë dhe nga çdo tas piu pak ujë. Në tasin e fundit la brenda unazën që kishte me vete. Për një moment u dëgjua në ajër zhurma e përplasjes së krahëve dhe xhuxhi i tha: "Ja u kthyen zotérinjtë sorra". Arritën sorrat. Kishin uri dhe etje. Çdonjëri prej tyre kërkonte pjatën dhe tasin e tij.

Pak më vonë pasi mbaruan së ngrëni njëri prej tyre tha: "Kush ka ngrënë në pjatën time? Kush ka pirë në tasin tim? Ka qenë një gojë njerëzore".

Dhe kur i shtati mbaroi ujin në fund të tasit u shfaq unaza. Ky e pa dhe njobu njëren nga unazat e mamasë dhe të babait. Atëherë tha: "Imzot nëse motra jonë është këtu do të jemi të lirë". Sapo vajza që rrinte e fshehur mbrapa derës tha dëshirën dhe hyri në dhomën e shtatë sorrave ata morën pamje njerëzore. U përqafuan e u puthën dhe u kthyen në shtëpi.

J. V. Grimm

Referenca

- A. de Saint-Exupéry, *Princi i vogël*, Botimet Toena, Tiranë, 2008.
- A. Podrimja, *Buzëqeshje në kafaz*, poezi, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
- B. Beci, *Për një konceptim bashkëkohor të mësimit të gjuhës amtare në shkollë*, "Gjuha jonë", ASH, IGJL, Tiranë, 1993.
- Chaney, T. Burk, *Teaching Oral Communication in grades K-8*, 1998.
- E. Mekuli, *Midis dashurisë dhe urrejtjes*, poezi, Naim Frashëri, 1981.
- Gjuha letrare shqipe (Pjesë nga poezia shqipe dhe pasqyra gramatikore), Tiranë, 1989.
- Hivzi Sulejmani, *Fëmijët e lumit tim*, Naim Frashëri, Tiranë, 1972.
- <https://www.dreamstime.com/>
- J. Boçari, *Borfor: Provat e Askanos*, Shtëpia botuese "Morava", Tiranë, 2010.
- J. K. Rowling, *Kafshët fantastike*, Ditura, Tiranë, 2018.
- K. Grillo, *Fjalor edukimi*, Tiranë, 2002.
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës e rishikuar, Prishtinë, gusht 2016.
- Kurrikula bërthamë e arsimit të mesëm të ulët të Kosovës, gusht 2016, Prishtinë.
- Kurrikula lëndore/programi mësimor për lëndën *Gjuhë shqipe 7*
- M. Kuteli, *Vepra letrare 5*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1990.
- M. Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Shkenca, Tiranë, 2004.
- N. Chamsky, *Aspects of the theory of Syntax* - MIT Press, Boston 1965.
- N. Mjeda, *Vjersha për të vegjël*, Naim Frashëri, Tiranë, Shqipëri 1967.
- O. Grillo, *Histori e Skënderbeut*, Shtëpia Botuese "Dituria", Tiranë, 2001.
- *Përralla popullore shqiptare*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1954.
- Prof. dr. M. Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2009.
- Prof. dr. M. Gjokutaj, Dr. Nj. Kazazi, *Prirja e sotme për mësimin e gjuhës shqipe*, Shkodër, 2003.
- Prof. dr. M. Gjokutaj, N.Mërkuri, *Modele të suksesshme mësimdhënieje*, Tiranë, 2008.
- Prof. dr. M. Gjokutaj, *Probleme të sotme të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë*, Tiranë, 2001.
- R. Elsie, *Gjirokastra nga udhëpërshkrimi i Evlija Çelebiut*, botuar në Albanica ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë, Prishtinë, nr. 66, 2007, f. 73-76 .
- R. Gjoshi, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Prizren, 2017.
- R. Gjoshi, *Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë (aspekte historike dhe didaktike)*, Prishtinë, 2016.
- R. Memushaj, *Shqipja standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2005.
- R. Qosja, *Antologji e lirikës shqipe*, Prishtinë, 1970.
- S. Krasniqi, *Besëlidhja shqiptare*, drama, Naim Frashëri, Tiranë, 1980.
- Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë, 2007.
- Standarde për tekstet shkollore Prishtinë, 2011
- Xh. Rodari, *Xhipi në televizor dhe ndodhi të tjera në orbitë*, Shtëpia Botuese Çabej, Tiranë, 2002.
- Z. Rrahmani, *Njohuri nga teoria e letërsisë*, Tiranë, 1996.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:811.18(076.1)(075.2)

Gjokutaj, Mimoza

Gjuhë shqipe 8 : fletore pune : për klasën e 8-të të arsimit
9-vjeçar / Mimoza Gjokutaj, Anila Mullahi, Tereza Basho
Babasuli. - Prishtinë : Pegi, 2024. - 90 f. : ilustr. ; 20.7 x 28 cm

1. Mullahi, Anila 2. Babasuli, Tereza Basho

ISBN 978-9951-843-21-8



Fletore pune Gjuhë shqipe

8

ISBN: 978-9951-843-21-8



9 789951 843218